

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE
SHQIPTARE SHA – KESH**

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Deri më 31 dhjetor 2020

(me raportin e audituesve të pavarur bashkëlidhur)

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020

(Shuma në mijë Lekë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktivët			
Aktive afatgjata materiale	6	82,271,565	84,541,879
Aktive financiare	7	9,816,016	10,109,797
Totali i aktiveve afatgjata		92,087,581	94,651,676
Inventarë	8	1,468,233	1,560,321
Aktive financiare	7	9,673,832	8,258,604
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9	63,097,846	62,125,240
Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare	10	1,046,432	985,226
Totali i aktiveve afatshkurtra		75,286,343	72,929,391
Totali i Aktiveve		167,373,924	167,581,068
Kapitali			
Kapitali aksionar	11	20,162,799	20,162,799
Kapitali i peregjistruar	11	(4,000)	(4,000)
Rezervat ligjore	11	2,643,824	2,643,824
Vlera e drejtë e huave	11	4,410,528	3,860,466
Rezerva të tjera	11	55,383,689	56,346,217
Humbje të mbartura		(12,070,802)	(7,620,525)
Totali i kapitalit		70,526,038	75,388,781
Detyrimet			
Huatë	12	40,348,609	26,934,823
Grantet	13	131,180	112,177
Totali i detyrimeve afatgjata		40,479,789	27,047,000
Huatë	12	40,581,337	52,674,574
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	14	14,493,977	11,302,287
Provizionet për çështje ligjore	15	1,293,195	1,168,426
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		56,368,097	65,145,287
Totali i Detyrimeve		96,847,886	92,192,287
Totali i Kapitalit dhe i Detyrimeve		167,373,924	167,581,068

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan për dorëzim nga drejtimi i KESH Sh.a më 28 dhjetor 2022 dhe janë firmosur si në vijim nga:

Z.Ergys Verdho
Administrator

Znj.Fitnete-Kociaj
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike

Z.Besjan Kadiu
Drejtor i Departamentit të
Përgjithshëm të Administratës

Znj.Eftiola Teko
Shef i Sektorit të Kontabilitetit

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shuma në mijë Lekë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	2020	2019
Të ardhura nga kontratat me klientët	16	5,997,653	6,907,938
Të ardhura të tjera operative	17	5,312,419	2,468,269
Të ardhura		11,310,072	9,376,207
Materiale dhe të lëndë të konsumueshme të përdorura		(74,853)	(75,350)
Energji e blerë	18	(378,429)	(385,208)
Fitimi bruto		10,856,790	8,915,649
Shpenzime për përfitime të personelit	19	(1,082,916)	(972,694)
Zhvlerësimi	6	(3,628,192)	(3,547,653)
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	5.2.1	(530,059)	469,000
Provizione për çështje ligjore	15	(189,769)	(194,872)
Shpenzime të tjera	20	(3,754,204)	(1,754,666)
		(9,185,140)	(6,000,885)
Rezultatet nga aktivitetet operative		1,671,650	2,914,764
Të ardhura financiare	21	625,363	926,930
Kosto financiare	21	(1,954,653)	(2,816,814)
Kostot financiare neto		(1,329,290)	(1,889,884)
Fitime para tatimit		342,360	1,024,880
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(945,321)	(783,875)
(Humbja)/Fitimi neto për vitin		(602,961)	241,005
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
<i>Të ardhura të tjera që nuk janë riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat vijuese (neto pa tatime):</i>			
Rivlerësim i aktiveve afatgjata materiale, neto i patatuar	6	-	1,568,490
(Humbje)/të ardhura të tjera neto gjithëpërfshirëse që nuk do të riklasifikohen për përfitime apo humbje në periudhat e mëvonshme			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(602,961)	1,809,495

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri ne 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shuma në mijë Lekë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	Kapitali aksionar	Kontributi kapital /reduktimi i parregjistruar	Rezervat ligjore	Rezervat e rivlerësimit	Vlera e drejtë e huave	Humbje të mbartura	Gjithsej
	20,162,799	(4,000)	2,643,824	54,889,816	4,702,728	(7,973,620)	74,421,547
Bilanci më 1 janar 2019	11.1	20,162,799	2,643,824	54,889,816	4,702,728	(7,973,620)	74,421,547
Fitimi për vitin	-	-	-	-	-	241,005	241,006
Rezerva shtesë e rivlerësimit	11.4	-	-	1,568,490	-	-	1,568,490
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	1,568,490	-	241,005	1,809,495
Transferimi nga rezerva e rivlerësimit	11.4	-	-	(112,089)	-	112,089	-
Transferime të rezervave ligjore	-	-	-	-	-	-	-
Rregullime të rezervës së rivlerësimit	11.5	-	-	-	(842,262)	-	(842,262)
Bilanci deri më 31 dhjetor 2019	11.1	20,162,799	2,643,824	56,346,217	3,860,466	(7,620,525)	75,388,781
Fitimi për vitin	-	-	-	-	-	(602,961)	(602,961)
Rezerva shtesë e rivlerësimit	-	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-	(602,961)	(602,961)
Transferimi nga rezerva e rivlerësimit	-	-	-	(962,528)	-	962,528	-
Transferime nga rezerva e sigurisë	-	-	-	-	-	-	-
Transferime të rezervave ligjore	-	-	-	-	-	-	-
Uljë e kapitalit aksionar	-	-	-	-	-	-	-
Rregullime të rezervës së rivlerësimit	11.5 /11.6	-	-	-	550,062	-	550,062
Rregullime për vitet e shkuara	11.6	-	-	-	-	(4,809,843)	(4,809,843)
Bilanci më 31 dhjetor 2020	20,162,799	(4,000)	2,643,824	55,383,689	4,410,528	(12,070,802)	70,526,038

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shuma në mijë Lekë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe)

	Shëni me	2020 LEK '000	2019 LEK '000
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative			
Humbje para tatimit		342,360	1,024,880
<i>Përshatjet për:</i>			
- Zhvlerësimi	6	3,628,192	3,547,653
- Provigjonet për çështjet gjyqësore	24	189,769	194,872
- Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	9	530,059	-
- Humbjet në inventar nga amortizimi	8	134,606	468,767
- Amortizim (kthim) / humbje në mjete monetare dhe të barasvlershme të mjeteve monetare	10	25	(364)
- Humbja nga zhvlerësimi i aktiveve financiare	7	-	(5,291)
- Provigjione të tjera		-	(1,321,856)
- Të ardhurat nga subvencionet dhe grantet	17	(1,452)	(3,556)
- Të ardhurat nga interesat	21	(625,363)	(507,228)
- Shpenzime interesi	21	1,727,094	2,816,814
- Ndryshimin në fitim/humbje nga kursi i këmbimit	21	227,559	(419,702)
<i>Ndryshime në:</i>			
- Inventarë		(42,518)	(14,147)
- Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera		3,203,854	446,911
- Të pagueshme tregtare dhe të tjera		3,326,296	(1,819,343)
		12,640,481	4,408,410
Interesi i paguar		(484,354)	(693,445)
Tatim mbi të ardhurat i paguar	22	(1,766,673)	(2,574,672)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		10,389,454	1,140,293
Fluksi i parave nga aktivitetet investuese			
Blerje ndërtesash, makinerish dhe pajisjesh	6	(1,660,787)	(2,336,830)
Flukse nga huatë e dhëna palëve të treta		3,656	425,912
Interesi i përfituar		9,978	34,389
Mjetet monetare në aktivitetet investuese		(1,647,153)	(1,876,529)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Të hyra nga huatë	5.4	22,547,755	13,115,412
Pagesa për huatë	5.4	(20,087,050)	(12,379,176)
Mjetet monetare nga aktivitetet financuese		2,460,706	736,236
Rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		11,203,007	(1,039,012)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar	10	(17,467,692)	(16,428,680)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 janar	10	(6,264,685)	(17,467,692)

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. ENTITETI RAPORTUES

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare – KESH sh.a dhe Shoqëritë e kontrolluara prej saj (“KESH” ose “Grupi”) është një shoqëri aksionare e themeluar në Republikën e Shqipërisë. Grupi u regjistrua më 31 dhjetor 1994 duke u bazuar në vendimin nr. 74 të Ministrisë së Financave, datë 2 nëntor 1995. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë zotëron plotësisht kapitalin aksionar të KESH-it më 31 dhjetor 2020.

Më 31 dhjetor 2020, Grupi zotëronte kapitalin aksionar të filialeve të “KESH Security SHRSF” sh.a (“KESH Security”) dhe “Termocentrali Vlorë” sh.a (“TEC Vlorë”). KESH Security u themelua më 7 Prill 2008 bazuar në vendimin nr. 14 të Këshillit Mbikëqyrës të Grupit dhe është përfshirë në sigurimin e shërbimeve të ruajtjes për Grupin. Bazuar në vendimin nr. 15 datë 28 shtator 2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Grupit dhe në vendimin nr. 2 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, u vendos të fillohet me procedurat e likuidimit të KESH Security. Shoqëria e kontrolluar nuk është materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

TEC Vlorë u regjistrua bazuar në Vendimin e Gjykatës nr. 3862, më 18 qershor 2007 si një shoqëri tërësisht e kontrolluar nga KESH sh.a. Aktiviteti kryesor i TEC Vlorë është gjenerimi i elektricitetit nga termocentrale. Grupi përfundoi ndërtimin e TEC-it në vitin 2012 dhe që atëherë, TEC-i nuk ka qenë asnjëherë në fazë prodhimi për shkak të një defekti në sistemin e ftohjes, i cili referuar VKM Nr. 480, datë 31 korrik 2018 parashikohet të transformohet dhe të përdorë gaz natyror pas ndërtimit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP). Shoqëria mëmë siguron mbështetje financiare për shpenzimet operative të TEC Vlorë si dhe për mirëmbajtjen e përgjithshme të termocentralit. Huaja e marrë për ndërtimin e TEC-it shlyhet nga KESH.

Bazuar në ligjin nr. 43/2015, datë 30 prill 2015 (“Ligji”), dhe në vendimin nr. 244 datë 30 mars 2016 të Këshillit të Ministrave, KESH ushtron rolin e prodhuesit të energjisë elektrike sipas të cilit Grupi duhet të furnizojë Furnizuesin Universal të Shërbimit (OSHEE) me një sasi të caktuar energjie për përmbushjen e kërkesës së konsumatorëve tariforë fundorë, me një çmim të rregulluar nga Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”). Kjo sasi do të përcaktohet në kontratën e rregulluar midis palëve të miratuara nga ERE dhe do të përcaktohet bazuar në nivelin e prodhimit mesatar historik të KESH duke supozuar një shfrytëzim racional të kapaciteteve të tij prodhuese (shiko shënimin 5.2.2).

Akte të tjera nënligjore dhe rregullatore të nevojshme për zbatimin e Ligjit u miratuan me Vendimin nr. 519, datë 13 korrik 2016, të Këshillit të Ministrave i cili miratoi modelin e ri të tregut të energjisë në mbështetje të Ligjit. Deri në nxjerrjen e këtij vendimi, KESH-i ka zbatuar rregullat e modelit të tregut që ishin në fuqi para daljes së, dhe sipas kërkesave të Ligjit (shiko shënimin 5.2.2).

Deri në vitin 2016, tarifa e shitjes së energjisë elektrike për KESH përcaktohej nga ERE, bazuar në një metodologji të aprovuar, ndërkohë duke nisur nga viti 2017 e në vijim, tarifa përcaktohet nga Ministria përgjegjëse (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2020, bazuar në vendimin nr. 10841/1 në 27 dhjetor 2018, MIE përcaktoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH sh.a. ndaj OSHEE sh.a. në masën 1.5 Lek/kWh, tarifën për shitjen e energjisë elektrike ndaj OST sh.a. në 1.5 Lek/kWh për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit dhe tarifën prej 158 Lek/MWh për shërbimet mbështetëse.

KESH aktualisht përbëhet nga KESH Security, TEC Vlorë, njësia e drejtorisë qendrore dhe nga tre njësi prodhuese hidroenergjetikë të vendosura në kaskadën e lumit Drin. Grupi e ka adresën zyrtare në Shqipëri. Adresa e zyrës së saj të regjistruar është Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Viktor Eftimi, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2020 KESH ka 719 punonjës (31 dhjetor 2019:). 722 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES**Deklaratë përputhshmërie**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Komiteti i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar (KIRFN) të BSNK.

Detaje për politikat kontabël të Grupit, janë përfshirë në Shënimin 4.

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**Baza e matjes**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç pronave, impianteve dhe pajisjeve të cilat janë matur fillimisht me vlerën e drejtë të tyre.

Vijimësia

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur me gjithë praninë e një sërë treguesve të vështirësive financiare, si huatë e konsiderueshme që janë maturuar për shlyerje, humbjet e hasura gjatë vitit aktual, vështirësitë me mbledhjen e disa zërave të arkëtueshëm të tregtisë për përmbushjen e detyrimeve aktuale, Shoqëria ka vlerësuar se nuk ka pasiguri materiale lidhur me aftësinë e vet për të pasur vijimësi në të ardhmen e parashikueshme.

Për shkak të rolit jetik që Shoqëria luan në ekonominë shqiptare, që përfshin sigurimin e energjisë elektrike me çmime të rregulluara konsiderueshëm nën çmimet e tregut, Shoqëria do të vijojë të marrë mbështetje nga qeveria për të vijuar t'i ofrojë shërbimet e veta ekonomisë së vendit edhe për vitin 2022 nga buxheti i shtetit përmes injektimit të kapitalit dhe gjithashtu duke zgjeruar portofolin e vet të prodhimit me asete të reja që plotësojnë burimet hidrike, si Implantet PV ose termocentralet, me kosto prodhimi të energjisë nën çmimet e tregut. Gjatë vitit 2022 me detyrimin e shtuar për shërbim publik, çmimi i shitjes së energjisë në kuadër të detyrimit për shërbim publik (PSO) është rritur (i) për konsumatorët fundorë me tension të ulët në 26 ALL/KWh +73% dhe (ii) për konsumatorët fundorë me tension të mesëm në 12 ALL/KWh +76%.

Grupi, bazuar në Ligjin Nr. 38/2021 dhe aktin nënligjor në formën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 485, datë 30.7.2021, po kryen një studim të plotë teknik dhe ekonomik të projektit të HEC-it Skavicë në rrjedhën e sipërme të kaskadës së Drinit.

Aktualisht, Projekti i Skavicës është në fund të fazës së studimeve teknike, me projekt VNMS të përgatitur, me projekt model financiar të përgatitur, me strukturë financiare në hartim e sipër, me projekt Kuadër Politikash për Rivendosjen të përgatitur, me aksin e Digës dhe kuotë maksimale operacionale të rezervuarit prej 420 - 442 metra mbi nivelin e detit që do t'i nënshtrohen miratimit përfundimtar bazuar në kostot e ndikimit social.

HEC-i i Skavicës, brenda kuotës së përcaktuar të rezervuarit do t'i japë kaskadës një volum të shtuar ruajtjeje uji ndërmjet 1.5-2.6 miliard metër kub, me kapacitet të instaluar prej 16-200 MW dhe shtim vjetor të prodhimit prej 0.6-0.8 TWh.

Projekti pritet të kalojë në fazën e dytë (projektimi i detajuar dhe ndërtimi) gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023. Ndërtimi mund të fillojë brenda vitit 2024 me kalendar të planifikuar punimesh dhe mbushje të rezervuarit të planifikuar brenda një periudhe 5 vjeçare.

Prania e Koronavirusit të ri (Covid-19) u konfirmua në fillim të vitit 2020 dhe ka shpërthyer dhe është përhapur tashmë përtej kufijve të Kinës duke i shkaktuar goditje të fuqishme biznesit dhe ekonomisë botërore në tërësi. Duke qenë se situata është ende e pranishme, në këtë moment Shoqëria nuk e konsideron të nevojshme të ndërmarrë një vlerësim sasior të ndikimit. Në përgjigje të pandemisë, Autoritetet Shqiptare zbatuan një sërë masash për kufizimin e përhapjes dhe ndikimit të COVID-19 si ndalimet e udhëtimit dhe kufizimet, karantinën, urdhrat e qëndrimit në shtëpi dhe kufizimet e lidhura me veprimtarinë e biznesit, përfshirë mbylljen e tyre. Ndër të tjera, këto masa kanë kufizuar rëndë veprimtarinë ekonomike në Shqipëri dhe kanë ndikuar negativisht dhe mund të vijojnë të ndikojnë negativisht bizneset, pjesëmarrësit në treg, klientët e Shoqërisë, si dhe ekonominë shqiptare dhe botërore për një periudhë të pacaktuar kohe.

Rënia në veprimtari gjatë vitit 2020 erdhi si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Pandemia shkaktoi konsum më të ulët të energjisë elektrike, dhe si pasojë mundësi më të pakta për tregti. Për vitin 2021, Grupi nuk pret të devijojë nga shifrat e buxhetit për shkak të situatës së pandemisë. Të ardhurat e gjeneruara deri në maj të vitit 2021 janë thuajse të barabartë me të ardhurat totale të gjeneruara gjatë vitit 2020. Për pasojë, ekipi drejtues beson se veprimtaria do të kthehet në nivelin përpara pandemisë dhe se Shoqëria nuk do të ketë probleme me përmbushjen e detyrimeve të veta ndaj Shoqërisë Mëmë dhe palëve të treta. Këto pasqyra financiare janë hartuar duke zbatuar parimin e vijueshmërisë, duke qenë se ekipi drejtues i Grupit beson se Grupi do të vijojë veprimtarinë e veta normale të tregtisë për periudhën 12 mujore që ndjek muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare.

Si rezultat e vlerësimit të mësipërm, parimi i vijueshmërisë në kuadër të hartimit të pasqyrave financiare është me vend.

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**Monedha funksionale dhe prezantuese**

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, që është monedha funksionale e Grupit. Të gjitha shumat janë paraqitur duke u përafëruar në mijëshen më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE, GJYKIMEVE DHE SUPOZIMEVE

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, Drejtimi ka përdorur gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël të Grupit dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe dhënien e informacioneve shpjeguese shoqëruese, dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të detyrimeve kontingjente. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë paravepruese.

Gjatë procesit të zbatimit të politikave të kontabilitetit të Grupit, menaxhimi ka bërë gjykime të ndryshme.

Ato të cilat menaxhimi ka vlerësuar se kanë ndikimin më domethënës në shumat e njohura në pasqyrat e konsoliduara financiare për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2020 janë diskutuar në shënimet e mëposhtme:

- Shënimi 4.j dhe 6.ii: testi i zhvlerësimit: supozimet kryesore dhe pasiguritë në vlerësim për përcaktimin e shumave të rikuperueshme;
- Shënimi 6.i: matja e aktiveve jo-financiare me vlerën e drejtë;
- Shënimi 4.k dhe 5.2.1: politika e zhvlerësimit dhe politika e provigjonimit së aktiveve financiare;
- Shënimi 4.g dhe 24: njohja dhe matja e provigjoneve dhe detyrimeve të mundshme: supozimet kryesore mbi mundësinë dhe madhësinë e flukseve ekonomike dalëse;
- Shënimi 4.c dhe 8: vlerësimi i vlerës neto të realizueshme të inventarit; dhe
- Shënimi 4.o, 15 dhe 22: njohja e aktiveve për tatime të shtyra: disponueshmëria e fitimit të tatueshëm në të ardhmen, ndaj të cilit mund të përdoren humbjet e mbartura tatimore;
- Shënimi 4 f, 5, 6, 7 dhe 9 matja fillestare e huave me norma interesi të përfutur nën normat e tregut, të cilat maten fillimisht me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, dhe që më pas maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.
- Shënimi 4 f, 5, 12 dhe 14: matjet vijuese të borxheve me pagesa të vonuara të konsiderueshme;
- Shënimi 24: supozimi dhe gjykimi që lidhet me detyrimet kontingjente.

3.1 Matja e vlerës së drejtë

Një numër politikash kontabël dhe shënimesh shpjeguese të Grupit kërkojnë matje sipas vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

Grupi ka angazhuar vlerësues të pavarur për të përcaktuar matje të konsiderueshme të vlerës së drejtë, duke përfshirë Nivelin 3 të vlerës së drejtë për aktivet jo-financiare. Menaxhimi vlerëson evidencën e marrë nga palët e treta për të mbështetur përfundimin se këto vlerësime përputhen me kërkesat e SNRF, duke përfshirë edhe nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilin vlerësime të tilla duhen klasifikuar. Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë që nuk shiten në një treg aktiv përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Grupi përdor gjykimin e tij për të zgjedhur një numër të ndryshëm metodash dhe bën supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet e tregut në çdo datë raportimi. Grupi përdor analizën e skontuar të flukseve të parasë për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk shiten në tregje aktive. Kur një aktiv ose detyrim matet me vlerën e drejtë, Grupi përdor të dhëna tregu të vëzhgueshme për sa është e mundur.

Vlerat e drejta janë të kategorizuara në nivele të ndryshme hierarkie në bazë të dhënave të përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

- Niveli 1: çmimi i kuotuar (i pa rregulluar) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta apo identike.
- Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar të përfshirë në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme ose drejtpërdrejt (p.sh. çmimet) ose në mënyrë indirekte (p.sh. ato që derivojnë nga çmimi) për një aktiv ose detyrim.
- Niveli 3: të dhëna për aktivin ose detyrimin, të cilat bazohen në të dhëna tregu të vëzhgueshme (të dhëna jo të vëzhgueshme).

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE, GJYKIMEVE DHE SUPOZIMEVE

3.1 Matja e vlerës së drejtë (vazhdimi)

Nëse të dhënat e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi janë në nivele të ndryshme hierarkie, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në nivelin më të ulët hierarkik ku përfshihen të dhënat kryesore që përdoren për matjen e vlerës së drejtë.

Grupi i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi. Informacione të mëtejshme për supozimet e bëra në matjen e vlerës së drejtë janë përfshirë në Shënimet 5.1 dhe 6.1.

3.2 Rritja e konsiderueshme e rrezikut të kredisë

Siç shpjegohet dhe më poshtë, humbjet e pritshme të kredisë maten si një provigjion i barabartë me humbjen e pritshme 12-mujore për instrumentet e Fazës 1, ose humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës për instrumente të Fazës 2 ose 3. Klasifikimi i aktiveve financiare të Grupit në secilën fazë paraqitet në Shënimin 5.2.1. Një instrument financiar lëviz në Fazën 2 kur rreziku i tij i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. SNRF 9 nuk e përcakton çfarë nënkupton një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë. Gjykimi është i nevojshëm për vlerësimin e shumës dhe periudhës për fluksin e mjeteve monetare në të ardhmen kur përcaktohen humbjet nga amortizimi dhe vlerësimi i një rritje të konsiderueshme në rrezik kredie. Këto vlerësime mbështeten në një sërë faktorësh, ndryshime të cilat mund të rezultojnë në nivele të ndryshme fondeve të lejuara. Për të vlerësuar nëse rreziku i kredisë të një instrumenti është rritur ndjeshëm apo jo, Grupi merr parasysh

- përdorimin e informacionit cilësor dhe sasior të arsyeshëm dhe të parashikuar;
- ndryshimet domethënëse të parashikimit ekonomik dhe ndikimit në skenarët dhe supozimet makroekonomike;
- karakteristikat e rrezikut si industria apo vendndodhja gjeografike e huamarrësve.
- prirjet e kohëve të fundit lidhur me treguesit e rrezikut të kredisë, si shkalla e kriminalitetit, shmangie dhe mospagim, si dhe prirjet e kohëve të fundit për sektorët e cenueshëm dhe pritshmëritë për muajt në vijim lidhur me tërheqjet e planifikuara dhe masat mbështetëse;

Huamarrësi më i konsiderueshëm i Grupit është OSHEE, operatori i shpërndarjes dhe furnizimit universal në Shqipëri. Bazuar në performancën e përgjithshme financiare të OSHEE-së në 5 vitet e fundit dhe kryesisht gjatë vitit 2021, gjatë cilit veprimtaria e shoqërisë është mbështetur nga buxheti i shtetit për shkak të faktit se është shoqëri shtetërore dhe se në strukturën aksionare, i vetmi aksionar i të dy shoqërive është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në sajë të mbështetjes madhore nga qeveria shqiptare, Menaxhimi vlerëson se rreziku i kredisë i OSHEE-së është i lidhur në proporcion të drejtë me riskun sovran shqiptar.

Që prej 1 janarit 2022, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 620/2021 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 456/2022 në fuqi, OSHEE (dhe të gjitha shoqëritë e saj bija) nuk i nënshtrohen më detyrimit të shërbimit publik (PSO) për të blerë në tregun e lirë të energjisë sasinë e energjisë që mungon dhe që nevojitet për përmbushjen e nevojave të konsumatorëve të vet. Bazuar në VKM-në e lartpërmendur, kjo PSO që mbart gjithashtu rrezikun hidrologjik në prodhimin e energjisë elektrike, është tashmë tërësisht e përqendruar tek KESH. Kjo strukturë PSO-je i jep grupit OSHEE vetëm detyra furnizimi dhe shpërndarjeje duke minimizuar rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë.

Përveç kësaj, duke konsideruar gjithashtu rolin e qeverisë shqiptare si garantor i OSHEE-së si një lloj kolaterali për shumën e papaguar, rreziku i kredisë ulet në mënyrë të konsiderueshme Bazuar në vlerësimin e Drejtimit, për llogaritë e arkëtueshme me OSHEE sh.a dhe OST sh.a është aplikuar "Qasja e përgjithshme".

Përveç kësaj, asnjë nga kriteret e përcaktuara në SNRF 9 nuk përmbushet kur vlerësohet rreziku i kredisë të OSHEE, prandaj është përdorur gjykimi profesional për të klasifikuar rrezikun e kredisë të OSHEE edhe OST në Fazën 1. Edhe pse ka më shumë se 90 ditë me vonesë për disa shuma, ekziston një marrëveshje në fuqi me Grupin që të gjitha këto shuma do të paguhen. Si pasojë, rreziku i kredisë vlerësohet të klasifikohet nën Fazën 1 për shkak të industrisë në të cilën operojnë OSHEE dhe OST dhe për shkak të marrëveshjes ndërmjet palëve për pagesën me këste të të gjithë bilancit të vjetër. Kështu, humbja e pritshme në kredi matet individualisht përmes "Qasjes së përgjithshme" duke përdorur humbjen e pritshme në kredi për 12 muaj, bazuar në: a) prirjen historike të pagesave nga OSHEE të faturave të prapambetura, ndërkohë që KESH ka rikuperuar shumën e balanceve të prapambetura dhe ka siguruar në vijim ofrimin (kështu që humbja e pritshme e kredisë 0.15%, 2019: ELC 14.4%); b) Nuk ka ngjarje aktuale / të pritshme / të ardhshme që priten të ndryshojnë rrezikun e kredisë të OSHEE-së, krahasuar me vitet e mëparshme.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE, GJYKIMEVE DHE SUPOZIMEVE (VAZHDIM)**3.2 Rritja e konsiderueshme e rrezikut të kredisë (vazhdimi)**

Sipas klasifikimit të rrezikut të kredisë të OSHEE dhe OST, (megjithëse ka një balancë të prapambetur që tejkalon periudhën prej 90 ditësh) ne kemi konsideruar të klasifikohet në Fazën I për arsyet e mëposhtme:

- OST dhe OSHEE janë entitete shtetërore dhe qeveria shqiptare vepron si garantor;
- Nuk është e mundur që OST të hyjë në falimentim.
- Efekti i vlerës së parasë në kohë për vonesën e pagesës konsiderohet i pakonsiderueshëm.
- Norma e mbledhjes nga FSHU (Grupi OSHEE) është rreth 98%, çka jep më shumë siguri.
- Rreziku hidrologjik i veprimtarisë së Grupit OSHEE është ulur duke qenë se (i) i gjithë Detyrimi për Shërbimin Publik për furnizimin me energji të të gjitha nevojave për FSHU-në (Furnizuesi Universal) është tashmë përgjegjësi e KESH-it dhe gjithashtu (ii) menaxhimi i suficiteve të prodhimit nga burimet e rinovueshme që prej janarit të vitit 2022 po bëhet përmes mekanizmit të depozitimit/këmbimit me KESH. Ju lutemi referojuni VKM Nr. 620/2021 dhe Nr. 456/2022.
- Rreziku i veprimtarisë për OST-në, ekspozimi i kësaj shoqërie ndaj çmimit të energjisë në treg për energjinë që i nevojitet OST-së për humbjet në sistemin e transmetimit menaxhohet përmes VKM Nr. 456/2022 duke transferuar në KESH të detyrimit për shërbimin publik, për t'i furnizuar OST-së këtë nevojë për energji me çmim të fiksuar prej 8,500 ALL/MWh, për të gjithë periudhën e gjendjes së emergjencës në sektorin e furnizimit me energji.

Klasifikimi në Fazën 2 për OSHEE dhe OST do të ishte i mundur në rast se:

- Një institucion publik do të falimentonte.
- Do të pritej përkeqësim i konsiderueshëm në rezultatet operative të OSHEE / OST të tilla si:
 - Rënie e konsumit të përgjithshëm të energjisë në shkallë kombëtare;
 - Blerje e paparashikueshme e energjisë me kosto shtesë si pasojë e uljes së rezervave.
- Nëse performanca financiare e entiteteve do të përkeqësohej për shkak të faktorëve të tjerë jo të lidhur me kushtet atmosferike.

Klasifikimi në Fazën 3 do të ishte i aplikueshëm nëse do të kishte plane konkrete të dhënies me koncesion nga shteti, nëse do të kishin vështirësi financiare apo do të falimentonin.

Llogaritja e provigjoneve

Gjatë matjes së humbjes së pritshme të kredisë, Grupi përdor informacion të arsyeshëm dhe të parashikuar, i cili bazohet në supozimet për lëvizjet e ardhshme të faktorëve të ndryshëm nxitës ekonomikë dhe se si këto faktorë do të ndikojnë tek njëri-tjetri.

Humbja nga mos shlyerja është një vlerësim i humbjes që vjen nga mospagimi, duke u bazuar në diferencën midis fluksit monetar kontraktual që paguhet dhe atij që pritet të merret. Implementimi i "Qasjes së Thjeshtuar" është përdorur për aktivet financiare, llogaritë e arkëtueshme dhe mjetet monetare dhe ekuivalentet me to. Sipas Drejtimit, analiza e vjetërsisë nuk është kryer e ndarë në 1-30 ditë, 30-60 ditë, 60-90 ditë edhe më shumë se 90 ditë, prandaj janë identifikuar vetëm gjendjet që nuk janë paguar për më shumë se 365 ditë.

Në lidhje me aktivet financiare, këto balanca përfshijnë kreditë e dhëna drejt OST sh.a, OSHEE sh.a edhe EPCG. Huatë nga OSHEE dhe OST janë klasifikuar në Fazën 3, duke qenë se nuk janë kryer pagesa që prej ndarjes (lidhur me periudhën nga viti 2004 deri 2007 gjatë së cilëve ishin pjesë e KESH).

Për më tepër, merret në konsideratë se Grupi ka detyrime financiare ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë (MFE) dhe se dy palët kanë rënë dakord se derisa Grupi të marrë pagesa nga OST dhe OSHEE, Grupi nuk do t'i bëjë pagesë përkatëse MFE-së. Kështu këto bilance zerohen me huatë e Grupit nga MFE-ja dhe kështu ekspozimi për mospagim i Grupit nuk ekziston gjatë të gjitha periudhave që lidhen aktivet financiare të OSHEE dhe OST. Për më tepër, EPCG-ja ka marrë gjithashtu hua nga Grupi dhe i ka paguar rregullisht këstet. Si pasojë, aktivet financiare nga EPCG-ja janë klasifikuar në Fazën 1. Megjithatë, siç është përmendur më lart, ekspozimi ndaj mospagimit për Grupin nuk ekziston gjatë të gjitha periudhave lidhur me aktivet financiare të EPCG-së.

Menaxhimi e ka konsideruar të arsyeshme të zbatojë një normë humbjeje prej 88% deri më datë 31 dhjetor 2020 për të gjitha të arkëtueshmet nga tregtia gjatë 365 ditëve dhe 75% për të gjitha të arkëtueshmet (77% më datë 31 dhjetor 2019). Ndërkohë që bazuar në një normë historike humbjeje kredie, për bilancet pa pagesë për një periudhë më të shkurtër se 365 ditë është zbatuar një normë prej 14% për të arkëtueshmet nga tregtia dhe një normë prej 1% për llogaritë e tjera të arkëtueshme (18%, 2% më 31 dhjetor 2019).

Një normë humbjeje prej 0.04% u zbatua për bilancet në mjete monetare dhe të tjera të barasvlershme më 31 dhjetor 2020.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)**3.2 Rritja e konsiderueshme e rrezikut të kredisë (vazhdimi)*****Llogaritja e provigjoneve (e llogaritur)***

Mundësia e mospagimit përbën një faktor kyç në matjen e humbjes së pritshme të kredisë. Mundësia e mospagimit është një vlerësim i mundshëm i mospagimit përgjatë një periudhë të caktuar kohore, llogaritja e të cilës përfshin të dhëna historike, supozime dhe pritshmëri për kushtet e ardhshme.

Tabela e mëposhtme prezanton analizën e sensitivitetit për normat e humbjes së pritshme të kredisë të llogarive të arkëtueshme, aktiveve financiare me vonesë më të ulët se 365 ditë, dhe mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to do të ishin 0.01% më të larta (ose ulëta) më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

Efekti në pozicionin financiar	2020		2019	
LEK '000	0.01 %	(0.01 %)	0.01 %	(0.01 %)
Të arkëtueshmet tregtare	6,164	(6,164)	5,895	(5,895)
Aktivët financiarë	1,948	(1,948)	1,793	(1,793)
Mjete Monetare dhe Ekuivalente të Mjeteve Monetare	105	(105)	99	(99)
Në '000 LEK	2020		2019	
Humbjet e pritshme të kredisë	0.01 %	(0.01 %)	0.01 %	(0.01 %)
Të arkëtueshme tregtare – OSHEE	91,188	79,789	82,316	71,641
Në '000 LEK	2020		2019	
Efekti në pozicionin financiar	0.01 %	(0.01 %)	0.01 %	(0.01 %)
Të arkëtueshme tregtare – OSHEE	5,699	(5,699)	5,337	(5,337)

Duke marrë në konsideratë se KESH ka detyrime financiare ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë (MFE) dhe se dy palët kanë rënë dakord se derisa KESH të marrë pagesa nga OST dhe OSHEE, KESH nuk do t'i bëjë pagesë përkatëse MFE-së. Kështu, këto bilance zerohen me huatë e KESH-it nga MFE-ja për qëllimet e vlerësimit të humbjes së pritshme të kredisë, dhe kështu konsiderohet që KESH-i nuk ka ekspozim për mospagim gjatë të gjitha periudhave që lidhen me aktivet financiare të OSHEE dhe OST.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Grupi ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

a. Bazat e konsolidimit**(i) Filiale**

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Grupi. Grupi kontrollon një filial kur është i ekspozuar ose ka të drejtën për kthime të ndryshueshme nga përfshirja e tij në njësinë ekonomike dhe ka aftësinë për të ndikuar në ato kthime nëpërmjet fuqisë së tij mbi njësinë ekonomike. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e mbarimit të tij.

(ii) Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit

Balancat dhe transaksionet brenda grupit, dhe ndonjë shumë e parealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda grupit janë eliminuar.

Fitimet e parealizuar që vijnë nga transaksionet me investimet e mbajtura sipas metodës së kapitalit eliminohen deri në masën e interesit që Grupi ka tek investimi. Humbjet e parealizuar janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuar, por deri në masën që nuk ka evidencë për zhvlerësim.

b. Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën korresponduese funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerë të drejtë në monedhë të huaj konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni.

c. Inventarë

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën hyrje e parë, dalje e parë (FIFO) dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, koston e prodhimit apo të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur koston e vlerësuar të përfundimit dhe shitjes.

d. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jo-materiale të blera nga Grupi janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar të zhvlerësimit. Shpenzimet në vijim të aktiveve afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha kostot e tjera njihen si shpenzim në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve afatgjata jomateriale.

e. Aktive afatgjata materiale**Njohja dhe matja**

Pronat, godinat, makineritë dhe pajisjet janë deklaruar në pasqyrat financiare të konsoliduara me shumën e tyre të rivlerësuar, dhe janë me vlerë të drejtë në datën e vlerësimit, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar që vjen si pasojë.

Rivlerësimet kryhen me rregullsi të mjaftueshme, aq sa vlerat kontabël nuk ndryshojnë në masë të konsiderueshme nga ato që do të përcaktoheshin përmes vlerave të drejta në fund të çdo periudhe raportimi.

Frekuenca e rivlerësimeve varet nga ndryshimet e vlerave të drejta të zërave të PPE-së që po rivlerësohet. Nëse vlera e drejtë e një aktivi të rivlerësuar ndryshon materialisht nga vlera e vet kontabël, atëherë është i nevojshëm një rivlerësim i mëtejshëm. Nëse një PPE i nënshtrohet ndryshimeve të rëndësishme dhe të paqëndrueshme në vlerën e vet të drejtë, rivlerësimi i përvitshëm mund të jetë i nevojshëm. Në të kundërt, periudha midis rivlerësimeve është tre deri në pesë vjet.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**e. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Sa i përket vlerës së mbartur të çdo aktivi që rritet si pasojë e një rivlerësimi, kjo rritje (suficit) njihet te të Ardhurat e Tjera Gjithëpërfshirëse ('ATGJ') dhe mbledhet si kapital nën titullin e rezervat e rivlerësimit. Megjithatë, rritja njihet në fitim dhe humbje për aq sa suficiti rezervon një rënie të mëparshme nga rivlerësimi (deficit) të të njëjtit aktiv që më parë është njohur në fitim ose humbje.

Sa i përket vlerës së mbartur të çdo aktivi që bie si rezultat i një rivlerësimi, rënia (deficiti) njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, rënia njihet në ATGJ për aq sa rezervon çdo bilanc kredie që ekziston në rivlerësim, lidhur me atë aktiv. Rënia e njohur në ATGJ ul shumën e mbledhur si kapital në titullin rezervat e rivlerësimit.

Pra, rritjet dhe rënitë e rivlerësimit nuk mund të fshihen, edhe brenda të njëjtës klase aktivesh. Rezerva e rivlerësimit përfshihet në rezervat e tjera (Shënim 11.4) dhe transferohet në të ardhurat e mbajtura ndërkohë që përdoren aktivet përkatëse.

Nëse pjesë të konsiderueshme të një artikulli AAM kanë kohëzgjatje të ndryshme pune, ato përllogariten si artikuj të veçantë (pjesët përbërëse kryesore) të tokës, impiantit dhe pajisjeve.

Ndërtimet në proces mbahen me kosto, minus humbjet e njohura nga zhvlerësimi (nëse ka) dhe klasifikohen në kategoritë e duhura të aktiveve afatgjata materiale kur përfundohen dhe janë të gatshme për përdorim. Kosto përfshin të gjitha shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me përfitim e aktivitet. Këto shpenzime përfshijnë tarifën profesionale, ndërsa për aktivet e kualifikuara koston e huamarrjes të kapitalizuara në përputhje me politikat kontabël të Grupit.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivi afatgjatë material njihet në fitim ose humbje.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohet vetëm nëse është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike të shoqëruara me shpenzimin do të rrjedhin drejt Grupit dhe kur fatura për mallrat merret së bashku me/ose pranimit provizor aprovohet.

Amortizimi

Amortizimi përllogaritet për të pakësuar shumën e rivlerësuar të aktiveve afatgjata materiale duke i zbritur vlerën e mbetur sipas metodës lineare të amortizimit përgjatë jetës së vlerësuar të dobishme, dhe njihet në fitim ose humbje. Jetët e dobishme të aktiveve afatgjata materiale për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si në vijim:

• Godinat	8 - 100 vite
• Makineritë dhe pajisjet	5 - 80 vite
• Mjete transporti	5 - 15 vite
• Mobilie dhe pajisje zyre	2 - 4 vite

Toka dhe ndërtimet në proces nuk amortizohen.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

f. Instrumentet financiare***Aktive financiare joderivative***

Grupi fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen. Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Grupi bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Grupi çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Grupit mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur Grupi transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin gjithë rrezikët dhe përfitimet nga pronësia e aktivitet financiar transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga Grupi, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë vetëm atëherë kur Grupi ka një të drejtë ligjore për të netuar shumën e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**f. Instrumentet financiare (vazhdim)*****Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera***

Të arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa të fiksuara ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërsëdrejti me to. Pas njohjes fillestare, të arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me kosto amortizimi me metodën e interesit efektiv, minus humbjet e zhvlerësimit. Grupi gjithmonë e mat provigjionin për llogaritë e arkëtueshme në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të përgjatë gjithë jetëgjatësisë. Humbjet e pritshme për llogaritë e arkëtueshme për llogariten duke përdorur një matricë provigjionimi me referencë nga eksperiencia e kaluar e mosshlyerjes nga ana e klientit dhe nga një analizë e pozicionit aktual financiar të tij, e rregulluar për faktorë që janë specifike për klientin, kushtet ekonomike të përgjithshme të industrisë në të cilën klientët operojnë dhe një vlerësim i rrjedhës së parashikuar dhe aktuale të kushteve në datën e raportimit. Grupi ka njohur një normë provigjioni prej 94% kundrejt të gjitha llogarive të arkëtueshme tregtare me 2 vite vonesë dhe një normë provigjioni prej 75% kundrejt të gjithave llogarive të arkëtueshme të tjera, sepse eksperiencia historike ka treguar se këto llogari janë përgjithësisht të rikuperueshme në këtë periudhë.

Nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në teknikat e vlerësimit apo në supozime të rëndësishme gjatë periudhës aktuale të raportimit. Grupi njih një fond provigjioni kur ka informacion që tregon se klienti është në vështirësi financiare dhe nuk ka një perspektivë realiste të rimëkëmbjes, p.sh. kur klienti është proces likuidimi ose ka hyrë në procedura të falimentimit, ose kur një llogari e arkëtueshme është mbi dy vjet e pashlyer, cilado që të ndodhë më herët.

Mjete Monetare dhe Ekuivalente të Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë mjetet monetare gjendje dhe depozitat me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Overdraftet bankare, që janë të ripagueshme sipas kërkesës dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të menaxhimit të mjeteve monetare të Grupit, përfshihen në mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në pasqyrën e flukseve monetare.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kjo qasje e bazuar në parime, zëvendëson kërkesat ekzistuese të bazuara në rregullat sipas SNK 39. Modeli i ri rezulton gjithashtu në një model të vetëm zhvlerësimi që aplikohet në të gjitha instrumentet financiare.

Zhvlerësimi - SNRF 9 ka prezantuar një model të ri për humbjet e pritshme nga zhvlerësimi që do të kërkojë njohjen më në kohë të humbjeve të pritshme të kredisë (humbjet nga kredie). Në mënyrë të veçantë, standardi i ri kërkon që njësitë ekonomike të japin llogari për humbjet e pritshme të kredisë që nga momenti kur instrumentet financiare njihen për herë të parë dhe të njihen humbjet e pritshme të jetës së aktivitetit në një bazë më të duhur.

Kontabiliteti i mbrojtjes - SNRF 9 paraqet një model të reformuar në mënyrë të konsiderueshme për kontabilitetin e mbrojtjes, ku është vendosur një rëndësi në aktivitetet e menaxhimit të rrezikut. Modeli i ri paraqet një rishikim të rëndësishëm të kontabilitetit të mbrojtjes që vendos në një linjë trajtimin kontabël me aktivitetet e menaxhimit të rrezikut.

Kompania ka zbatuar SNRF 9 në përputhje me dispozitat kalimtare të paraqitura në SNRF 9 në lidhje me Zhvlerësimin e Aktiveve Financiare më 31 dhjetor 2017 (implementimi i hershëm). Aplikimi i IFRS 9 nuk ka impakt në pozicionin financiar apo në performancën e Kompanisë në lidhje me klasifikimin dhe matjen dhe kontabilitetin e mbrojtjes.

Në lidhje me zhvlerësimin e aktiveve financiare, SNRF 9 prezanton një model të humbjeve të pritshme, në krahasim me SNK 39 që paraqet një model të humbjeve të ndodhura. Modeli i humbjeve të pritshme kërkon që Kompania të regjistrojë humbjet e pritshme të kredisë dhe ndryshimet në ato humbje të pritshme në çdo datë raportimi, për të pasqyruar ndryshimet në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare e aktiveve financiare. Me fjalë të tjera, nuk është më e nevojshme për një ngjarje kredie që të ketë ndodhur para se të njihen humbjet e kredisë.

Specifikisht, SNRF 9 kërkon që Kompania të njohë një provigjion për humbjet e pritshme për:

- i. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera
- ii. Aktive financiare; dhe
- iii. Mjete monetare dhe ekuivalente me to.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**f. Instrumentet financiare (vazhdim)*****Mjete Monetare dhe Ekuivalente të Mjeteve Monetare (vazhdim)******Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)***

Në veçanti, SNRF 9 kërkon që Kompania të matë provigjonin për humbjen e një instrumenti financiar, në shumë të barabartë me humbjen e pritshme përgjatë gjithë jetës së tij nëse rreziku i kredisë të atij instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare.

Megjithatë, nëse rreziku i kredisë të një instrumenti financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare, një Shoqëri duhet të matë provigjonin për humbjen e atij instrumenti financiar, në shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë për 12 muaj.

SNRF 9 gjithashtu kërkon një Qasje të Thjeshtuar për matjen e provigjonit, në shumë të barabartë përgjatë gjithë jetës së llogarive të arkëtueshme dhe të tjera, si dhe aktiveve financiare.

Kompania ka zgjedhur të mos riparaqesë krahasimet që përcaktojnë nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare e instrumenteve financiare ekzistues në datën e njohjes fillestare të SNRF 9 (31 dhjetor 2017). Menaxhimi ka krahasuar rrezikun e kredisë të instrumenteve financiare respektive në datën e njohjes së tyre fillestare të rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2017.

Detyrimet financiare jo derivative

Grupi fillimisht njeh detyrime financiare në datën e tregtisë në të cilën Grupi bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Grupi nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet e veta kontraktuale shkarkohen, anulohen ose përfundojnë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë vetëm atëherë kur Grupi ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Grupi ka këto detyrime financiare jo derivative: hua, tregti dhe të pagueshme të tjera. Këto detyrime financiare janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë plus të gjitha kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me to.

Për huatë e mara drejtpërsëdrejti nga bankat ndërkombëtare për zhvillim, norma e tregut përcaktohet nga pikëpamja e bankave për zhvillim dhe është përgjithësisht e barabartë me normën e kontratës, duke qenë se bankat për zhvillim janë tregun për Grupin.

Për fondet e financuara fillimisht nga bankat ndërkombëtare për zhvillim dhe më pas të dhëna si hua KESH sh.a. nga ana e Qeverisë, norma e tregut përcaktohet fillimisht duke iu referuar normave të ofruara nga bankat ndërkombëtare për zhvillim. Diferenca midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe vlerës nominale të huasë konsiderohet si kontribut nga aksionari dhe regjistrohët në kontabilitet si një rezervë rivlerësimi në kapital.

Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën e interesit efektiv.

g. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Modeli i zhvlerësimit në SNRF 9 bazohet në modelin e humbjeve të pritshme nga krediti ("HPK") dhe zëvendëson modelin e humbjeve të hasura të SNK 39, duke sjellë një njohje të humbjeve të lejuara përpara se të ndodhë humbja e kredisë. Sipas kësaj qasje Grupi konsideron kushtet aktuale dhe informacionin e arsyeshëm dhe të qëndrueshëm të disponueshëm për të ardhmen të mos ketë kosto apo përpjekje gjatë vlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë. SNRF 9 përcakton një "qasje të përgjithshme" lidhur me zhvlerësimin. Modeli HPK zbatohet për instrumentet financiare të njohura me kosto amortizimi ose vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Parimi drejtues i modelit HPK është të pasqyrojë një model të përgjithshëm përkeqësimi, ose përmirësimi në cilësinë e kredisë të instrumenteve financiare.

Një aktiv financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes matet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka prova objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar është i zhvlerësuar nëse provat objektive tregojnë se ka ndodhur një ngjarje që ka rezultuar në humbje pas njohjes fillestare të aktivit, dhe se ngjarja ka pasur ndikim negativ në flukset e parashikuara të mjeteve monetare nga ai aktiv, të cilat mund të maten me besueshmëri.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**g. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)*****Qasja e përgjithshme***

SNRF 9 përcakton një "qasje të përgjithshme" lidhur me zhvlerësimin. Bazuar në këtë "qasje të përgjithshme", një provigjion për humbjet e pritshme të kredisë njihet për një instrument financiar nëse është ka pasur rritje të konsiderueshme të riskut të kredisë (matur me anë të probabilitetit afatgjatë për faliment) që prej njohjes fillestare të aktivitetit financiar. Nëse në datën e raportimit, risku i kredisë të një instrumenti financiar nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme që prej njohjes fillestare, atëherë njihet provigjioni për humbjet e pritshme 12 mujore të kredisë. Me fjalë të tjera, "Qasja e Përgjithshme" ka dy baza për të matur humbjet e pritura të kredisë:

a) Humbjet e pritura 12-mujore;

Humbja e pritur 12 mujore e kredisë është pjesa e humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetës që paraqesin humbjet e pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e falimentimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

b) Humbjet e pritura përgjatë gjithë jetëgjatësisë.

Humbja e pritur gjatë gjithë jetëgjatësisë është humbja e pritur e kredisë që rezulton nga të gjitha ngjarjet e mundshme të falimentimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

Në përcaktimin e zhvlerësimit për modelin e thjeshtuar Grupi përdor trendin historik të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar, korrigjuar sipas gjykimit të drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredidhënies janë të tilla që humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provigjioni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim-humbje.

h. Provigjionet

Një provigjion njihet, nëse si pasojë e një ngjarje në të shkuarën, Grupi ka detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe nëse ka probabilitet që për likuidimin e detyrimit do të duhet të kryhet pagesë në përfitime ekonomike. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritshme të mjeteve monetare në një data përpara tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe riskun specifik për detyrimin. Zbritja e skontimit njihet si kosto finance.

i. Grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Grupi do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur atyre. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Grantet që kompensojnë Grupin për koston e aktiveve, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

j. Kapitali aksionar dhe dividendët***Kapitali aksionar***

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin e Grupit njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit si detyrim në periudhën në të cilën aprovohen nga aksionari i Grupit.

k. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**k. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)**

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar bashkë në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavarura nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (njësia e gjenerimit të parasë ose "CGU").

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e CGU-së së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet e njohura nga zhvlerësimi i CGU-ve shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (grupin e njësive) në mënyrë përpjesëtimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

l. Njohja e të ardhurave

- Të ardhura nga kontratat me klientët

Të ardhurat vijnë nga veprimtaritë e zakonshme të Grupit që janë shitja e energjisë si dhe ofrimi dhe zbatimi i shërbimeve përkatëse mbështetëse.

Grupi përcaktoi natyrën e premtimit të tij për qëllimet e zbatimit të SNRF 15 duke:

- Identifikuar mallrat ose shërbimet specifike që do t'i ofrohen klientit; dhe
- Vlerësuar nëse kontrollon çdo mall apo shërbim të përcaktuar përpara se shërbimi t'i transferohet klientit.

Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve i transferohet klientit, me një vlerë që pasqyron konsideratën të cilën Grupi beson se duhet ta përfitojë në këmbim të këtyre mallrave ose shërbimeve. Në përgjithësi, Grupi ka arritur në përfundimin se është pala parësore në marrëveshjet e veta për të ardhurat, sepse ai kontrollon mallra dhe shërbimet përpara se t'ia transferojë ato klientit.

Të ardhurat njihen në shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma e konsideratës të cilën Grupi beson se duhet ta përfitojë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat ose shërbimet një klienti. Të ardhurat përfaqësojnë vlerën fikse ose të përcaktueshme të konsideratës që është arkëtuar ose është e arkëtueshme. Të ardhurat njihen pa uljet, kthimet, kompensimet dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Sa më poshtë jep informacion mbi natyrën dhe afatet e përmbushjes së detyrimeve të performancës.

- Të ardhurat nga shitja e elektricitetit tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ("OSHEE") njihen bazuar në sasinë e vërtetë të energjisë së përçuar, matur në pikën e shpërndarjes dhe duke zbritur humbjet në transmetim.
- Shitja e elektricitetit për mbulimin e humbjeve të OSHEE" është zero për vitin 2020, për shkak të vitit të dobët hidrologjik (prurje të ulëta uji në basenin e Drinit), dhe KESH nuk pati mundësi të prodhonte energji elektrike për humbjet në rrjet që hasen nga OSHEE.
- Të ardhurat nga shitja e elektricitetit OST-së përfshin furnizimin (shitjen) nga ana e KESH dhe sigurimin (blerjen) nga shërbimi i balancimit (balancimi i kapacitetit të energjisë) i OST që do të përdoret për balancimin e sistemit të energjisë elektrike sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Të gjitha diferencat që mund të lindin konsiderohen energji balancimi, nëse justifikohen nga kërkesa e OST për të rritur/ulur energjinë e prodhuar ose nëse rezultojnë se ka shërbyer për balancimin e sistemit.

Për më shumë detaje, referojuni të Ardhurave nga kontratat me klientin (Shënimi 15).

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m. Shpenzime

Në rrjedhën normale të biznesit, Grupi njihet shpenzime. Shpenzimet njihen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve në bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

n. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit si edhe fitimet ose humbjet nga huatë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes raportohen mbi bazë neto.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huatë dhe njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

o. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Grupi pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës në baza neto, ose aktivet dhe pasivet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Taksat e tjera që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Grupi njihen në të njëjtën kohë si detyrimi për të paguar dividendin e lidhur me të.

Një aktiv tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. [SNK 12.24, 34]. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**p. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)**

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Kontratat aktuale të shoqërisë nuk i plotësojnë kushtet për tu trajtuar me SNRF 16.

q. Përfitimet e punonjësve***Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit***

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Grupi është i detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Grupi është i angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur Grupi njeh kosto ristrukturimi. Përfitimet nuk priten të shlyhen plotësisht brenda 12 muajsh nga data e raportimit kur ato janë të skontuara.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

r. Klasifikimi aktual kundër afatgjatë

Grupi paraqet aktive dhe detyrime në deklaratën e pozicionit financiar bazuar në klasifikimin aktual/afatgjatë. Një aktiv është aktual kur ai:

- Pritet të realizohet ose synohet të shitet ose të konsumohet brenda ciklin normal të operimit
- Mbahet kryesisht për qëllime tregtimi
- Pritet të realizohet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit; ose
- Është mjet monetar ose i barasvlershëm me të, përveç rasteve kur nuk lejohet këmbimi ose përdorimi për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit.

Të gjitha aktivet e tjera klasifikohen si afatgjata.

Një detyrim është aktual kur:

- Pritet të shlyhet gjatë ciklin normal të operimit
- Ai mbahet kryesisht për qëllime tregtimi
- Duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit; ose
- Nuk ka asnjë të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyerjes së detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit

Termat e detyrimit që, bazuar në zgjedhjen e palës homologe, mund të rezultojë në shlyerje përmes instrumenteve të kapitalit nuk ndikojnë klasifikimin e tij.

Grupi i klasifikon të gjitha detyrimet e tjera si afatgjata.

s. Standarde dhe interpretime të reja

Standardet e reja dhe shtesat në standardet aktuale, si më poshtë, të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë në fuqi për periudhën aktuale të raportimit.

Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe). Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të konsoliduara.

- *Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria.*

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri janë publikuar, por ende nuk janë efektive:

SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" përfshirë përmirësimet e SNRF 17 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),

Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" – Referencë e Kuadrit Konceptual me përmirësimet e SNRF 3, (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022),

Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" – Zgjatje e Përgjashtimeve të përkohshme nga aplikimi i SNRF 9 (data e mbarimit për përgjashtimet e përkohshme nga SNRF 9 u zgjat në periudha vjetore duke nisur në ose pas 1 janar 2023,

Ndryshimet e SNK 1 "Klasifikimi i Detyrimeve i Aktuale ose Afatgjata" - Në janar të vitit 2020, IASB nxori ndryshimet e pikave 69 deri 76 të IAS 1 për të specifikuar kërkesat për klasifikimin e detyrimeve si aktuale ose afatgjata. Ndryshimet janë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që nisin më ose pas datës 1 janar 2024 dhe duhet të zbatohen me prapaveprim.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

s. Standarde dhe interpretime të reja (vazhdim)

- *Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria (vazhdim)*

Ndryshimet e SNK 8 - "Përkufizimi i Vlerësimeve të Kontabilitetit - ndryshimet sqarojnë dallimin ndërmjet ndryshimeve në vlerësimet e kontabilitetit dhe ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe korrigjimin e gabimeve. Ato gjithashtu sqarojnë se si subjektet përdorin teknikat e matjes dhe inputet për të hartuar vlerësime kontabiliteti (në fuqi për periudhat vjetore që nisin më ose pas datës 1 janar 2023)

Ndryshimet në SNRF 10 "Konsolidimi i pasqyrave financiare" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"- Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose ndërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për një kohë të pacaktuar deri në përfundimin e projektit kërkimor mbi metodën e kapitalit)

Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"- Koncesionet e Qirasë në lidhje me Covid-19 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet zbatimi i mëparshëm, përfshirë pasqyrat financiare që nuk janë autorizuar ende për tu lëshuar në 28 maj 2020. 2020. Ndryshimi është gjithashtu i disponueshëm për raportet e ndërmjetme.)

Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" - Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),

Ndryshimet në SNK 16 "Prona, makineri dhe pajisje" - Të ardhura para përdorimit të synuar (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022)

Ndryshimet e NSK 37 "Kontratat me Kushte Rënduese - Kostot e Përmbushje së një Kontrate" - Ndryshimet gjejnë zbatim për "qasje të kostos me lidhje direkte". Kostot që lidhen direkt me një kontratë për ofrimin e mallrave ose shërbimeve përfshijnë si kostot për njësi shtesë, ashtu edhe një përcaktim të kostove që lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtaritë e kontratës. Reforma (gjen zbatim për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022).

SNRF 9 Instrumentet Financiare "Tarifat në testin '10 përqind' për çregjistrimin e detyrimeve financiare" - Ndryshimi sqaron tarifat që një subjekt përfshin kur vlerëson nëse termat e një detyrimi të ri të modifikuar financiar janë në thelb të ndryshme nga termat e detyrimit financiar original (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022).

Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare", SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Shënimet Shpjeguese" SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" dhe SNRF 16 "Qira" - Reforma e Normës së Interesit bazë (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2021)

Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF (cikli 2018 -2020)" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9 dhe SNK 41 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2022. Ndryshimi në SNRF 16 ka të bëjë vetëm me një shembull ilustrues, kështu që nuk deklarohet asnjë datë efektive).

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të konsoliduara Shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**t. Informacion krahasues**

Informacioni krahasues paraqitet vazhdimisht duke zbatuar politikat e kontabilitetit të Grupit. Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për qëllime krahasimi. Gabimet janë përfshirë për paraveprim në vitin që ato janë identifikuar. Korrigjimi prapaveprues nuk lejohet përveç rasteve kur ka një udhëzim të veçantë nga rregullatori. Grupi ka bërë riklasifikimet e mëposhtme me qëllim përfitim të një paraqitje dhe publikimi më të mirë të pasqyrave financiare të konsoliduara të grupit deri më 31 dhjetor 2019. Më specifikisht, Grupi ka kryer riklasifikimet e mëposhtme:

- Tregtia dhe të Pagueshme e Tjera (Shënimi 14) janë riklasifikuar si më poshtë në zërat e shënimit:
 - Të pagueshme lidhur me SHKEE prej 137,831 mijë Lek paraqitet te zëri i shënimit "Të pagueshme lidhur me SHKEE" në vend të "Të Pagueshme të Tjera";
 - Dividend i pagueshëm ish aksionarit prej 603,909 mijë Lek paraqitet te zëri i shënimit "Dividend i pagueshëm" në vend të "Të pagueshme të tjera"
 - Të pagueshme për penalizime TVSH-je prej 375,409 mijë Lek paraqiten te "Autoritete tatimore - Të pagueshme TVSH" në vend të "Autoritete tatimore - Të pagueshme të tjera"
- Huamarrjet nga Bankat me garanci sovraane prej 3,900,208 mijë Lek (aktuale) dhe 182,055 mijë Lek (afatgjata) për të cilat MFE ka paguar detyrimin për principalin dhe interesit, janë deklaruar veçmas nga Huamarrjet nga Bankat (Shënimi 12).

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERAT E DREJTA DHE MENAXHIMI I RISKUT**5.1 Kontabiliteti, klasifikimet dhe vlerat e drejta****5.1.1 Instrumentet financiare që nuk maten me vlerë të drejtë**

Të arkëtueshme tregtare aktuale të Grupit kanë vlerë të drejtë të vlerësuar përafërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër. Edhe për shumicën e të arkëtueshmeve jo-korrente, vlerat e drejta nuk janë konsiderueshëm të ndryshme nga shumat e tyre kontabël. Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve tregtare me OSHEE është thelbësisht e ndryshme nga shumat e tyre kontabël për shkak të modifikimit të termave të shlyerjes në periudhën afatgjatë me normë interesi zero.

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Shuma kontabël	Vlera e drejtë (niveli 3)	Vlera kontabël	Vlera e drejtë (niveli 3)
Të arkëtueshmet tregtare me OSHEE (Shënimi 9)	56,992,414	25,353,213	53,382,518	24,656,838
Aktivitet financiar (Shënimi 7)	19,489,849	19,533,350	18,368,401	17,474,592

Vlerat e drejta janë përllogaritur bazuar në flukset e mjeteve monetare të skontuara me normën aktuale të huadhënies. Ato klasifikohen si vlera të drejta të nivelit 3 në hierarkinë e vlerave të drejta, për shkak të përfshirjes së hyrjeve të pavëzhgueshme, që përfshijnë risk kredie nga pala homologe.

Grupi është palë në huamarrje afatgjata me norma interesi nën normat e tregut të matura me vlerë të drejtë përmes fitimeve dhe humbjeve dhe menaxhimi ka kryer analizë për përcaktimin e vlerave të tyre të drejta. Tabela në vijim tregon shumat e mbartura dhe vlerat e drejta të këtyre huamarrjeve afatgjata dhe afatshkurtra deri më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Shuma kontabël	Vlera e drejtë (niveli 3)	Shuma kontabël	Vlera e drejtë (niveli 3)
Huamarrja aktuale (Shënimi 12)	40,581,337	39,469,164	52,674,574	31,142,723
Huamarrja afatgjatë (Shënimi 12)	40,348,609	33,931,183	26,934,823	28,331,722

Vlera e drejtë vlerësohet si vlera e tashme e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare, skontuar me normat e interesit për huamarrje të ngjashme në datën e raportimit. Normat e interesit të përdorura për skontimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për huatë/disbursimet e pashlyera gjatë viteve 2020 dhe 2019 variojnë nga 0.08% deri në 2.66%.

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERAT E DREJTA DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)**5.1 Kontabiliteti, klasifikimet dhe vlerat e drejta (Vazhdim)****5.1.1 Instrumentet financiare që nuk maten me vlerë të drejtë (Vazhdim)**

Të gjitha normat e interesit të përdorura për skontimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare janë përcaktuar duke përdorur normat e interesit të ofruara në treg nga bankat për zhvillim. Menaxhimi arriti në përfundimin se nuk ka të dhëna tregu të disponueshme publikisht, të cilat mund të përdoren pa ndryshime të konsiderueshme për përcaktimin e vlerave të drejta të përshtatshme për huamarrjet afatgjata. Një sërë risqesh dhe rrethanash ndikojnë përcaktimin e vlerave të drejta të këtyre instrumenteve financiare, përfshirë shumën e instrumentit financiar, maturimin, besueshmërinë e kreditimit, llojin e interesit, valutën, qëllimin e huasë, garancitë, mjedisin ekonomik në të cilin palët e instrumentit financiar veprojnë, dhe riskun e huasë së keqe nga vetë huamarrësi.

Për shkak të mungesës së të dhënave të tregut drejtpërsëdrejti të vëzhgueshme lidhur me risqet dhe rrethanat e këtyre instrumenteve financiare, vlerat e drejta më sipër mund të konsiderohen vetëm si përafrime të arsyeshme për vlerat e drejta dhe që përmbushin kriteret për klasifikim në nivelin e tretë të hierarkisë së vlerës së drejtë. Megjithatë Grupi beson se vlerat e drejta të përlogaritura janë të arsyeshme, përdorimi i metodologjive dhe supozimeve të tjera mund të rezultojnë në vlera të tjera të drejta.

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe mjeteve të barasvlershme me to, tregtisë dhe të arkëtueshmeve të tjera, si dhe të pagueshmeve konsiderohet se përafron shumën e tyre të mbartur duke qenë se janë instrumente afatshkurtra pa interes.

Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve financiare afatgjata përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Vlera e drejtë vlerësohet si vlera e tashme e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare, skontuar me normat e interesit në datën e raportimit.

5.2 Menaxhimi i riskut financiar

Grupi është i ekspozuar ndaj risqeve në vijim që vijnë nga instrumentet financiare:

- risku i kredisë;
- risku i tregut; dhe
- risku i likuiditetit

Funksioni i menaxhimit të riskut në Grup kryhet në lidhje risqet financiare (kredi, treg, valutë, likuiditet dhe normë interesi). Objektivat parësorë të funksionit të menaxhimit të riskut financiar janë të përcaktojnë kufijtë e riskut dhe më pas të sigurojë që ekspozimi ndaj riskut të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të riskut operacional dhe juridik kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për minimizimin e risqeve operationale dhe juridike.

Zhvillimet aktuale

Menaxhimi i Grupit kryen monitorim të rregullt të pozicioneve të përgjithshme të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare. Bazuar në këto, menaxhimi analizon fitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve, dhe rreket të zbatojë masat e përshtatshme lidhur me kredinë, tregun (kryesisht çmimet e energjisë dhe normën e interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga pasiguritë e jashtme. Për më tepër, Grupi është i financuar nga bankat ndërkombëtare për zhvillim ose nënhuazime nga Qeveria apo palët përkatëse. Në këtë mënyrë, Grupi i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut, duke ruajtur stabilitet në kapital.

5.2.1 Risku i kredisë

Grupi është i ekspozuar nga riskut të kredisë, që është risk që një palë e instrumentit financiar t'i shkaktojë humbje financiare palës tjetër duke mos arritur të përmbushë një detyrim. Ekspozimi kryesor i Grupit ndaj riskut të kredisë vjen si pasojë e të arkëtueshmeve financiare, të tregtisë dhe të llojeve të tjera

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)**5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****5.2.1 Risku i kredisë (Vazhdim)**

Ekspozimi maksimal i grupit pas përcaktimit të riskut të kredisë sipas kategorisë së instrumentit financiar dhe sipas palës homologe është si vijon:

2020				
	Mjete monetare dhe ekuivalentë me to.	Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	Aktive financiare të arkëtueshme	Gjithsej
Mjete monetare dhe të barasvlershme në banka (Shënimi 10)	1,046,432	-	-	1,046,432
OSHEE (kontrolluar nga shteti)	-	56,908,034	10,884,469	67,792,503
OST (kontrolluar nga shteti)	-	4,637,603	8,523,371	13,160,974
FSHU	-	645,803	-	645,803
Punonjës	-	-	9,327	9,327
Subjekte të tjera	-	906,406	72,682	979,088
Ekspozimi total maksimal ndaj riskut të kredisë	1,046,432	63,097,846	19,489,849	83,634,127

2019				
	Mjete monetare dhe ekuivalentë me to.	Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	Aktive financiare të arkëtueshme	Gjithsej
Mjete monetare në banka dhe në tranzit (Shënimi 10)	985, 924	-	-	985, 924
OSHEE (kontrolluar nga shteti)	-	53,382,518	10,612,099	63,994,617
OST (kontrolluar nga shteti)	-	4,296,376	7,669,416	11,965,792
Punonjës	-	-	10,116	10,116
Subjekte të tjera	-	4,446,346	76,770	4,523,116
Ekspozimi total maksimal ndaj riskut të kredisë	985,924	62,125,240	18,368,401	81,479,565

Menaxhimi i riskut të kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj riskut të kredisë në punën e përditshme, sepse është e mundur që palët homologe të mos arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre financiare. Risku i kredisë që vjen nga të arkëtueshmet financiare lidhur me fondet që janë marrë fillimisht hua nga Grupi nga institucione të ndryshme (Shënimi 7) menaxhohet dhe monitorohet bazuar në marrëveshjet e nënkuadërimit me përfituesit e projekteve të financuara me këto fonde. Këto projekte përfshijnë kushte dhe angazhime kapitale që e ndihmojnë Grupin në monitorimin dhe minimizimin e riskut të kredisë. Këto angazhime analizohen dhe monitorohen rregullisht sipas kërkesave të kontratës fillestare të huamarrjes.

Përqendrimi i riskut të kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj përqendrimeve të riskut të kredisë. Menaxhimi monitoron përqendrimin e riskut të kredisë por has vështirësi në zbatimin e praktikës më të mirë të politikave të menaxhimit për ekspozimin e Grupit për këtë risk, për shkak të mungesës së diversifikimit të portofolit të klientit. Sipas modelit aktual të tregut, Grupi është i detyruar të furnizojë OSHEE-në me energjinë e nevojshme për përmbushjen e kërkesës së konsumatorët tariforë fundorë. Në këto rrethana, zbatimi i masave të diversifikimit është i vështirë dhe OSHEE përbën përqendrimin kryesor.

Më 31 dhjetor 2020, bilanci i të arkëtueshmeve nga OSHEE, përbën 89.4% të ekspozimit total maksimal ndaj riskut të kredisë (2019: 85.9%).

Zhvlerësimi

Për më tepër, bazuar në një marrëveshje huaje të nënshkruar nga Qeveria e Shqipërisë me IBRD në vitin 2014, OSHEE ka hapur një Llogari Escrow për depozitimin e të ardhurave mujore me qëllim pagesën e energjisë së blerë, sipas një kalendari për të cilin është rënë dakord. Ndonëse pagesat minimale mujore kanë këtë planifikim, OSHEE-ja ka detyrimin që t'ia shlyejë Grupit shumat plotësisht.

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.1 Risku i kredisë (vazhdim)

Pasiguria më e madhe në përlogaritjen e hapësirës për zhvlerësim është koha kur OSHEE-ja do të shlyejë të arkëtueshmet e vjetra, të cilat nuk janë paguar për më shumë se një vit. Drejtuesit mendojnë se kjo varet kryesisht nga përfshirja e kërkuar e qeverisë shqiptare, në cilësinë e saj si kontrolluese e përbashkët e KESH-it dhe OSHEE-së. Në datën e raportimit, drejtuesit mendojnë se ka tregues që qeveria shqiptare i parashikon veprimet ose masat që adresojnë sheshimin e këtyre transaksioneve. Në kuadër të marrëveshjes së huamarrjes që KESH-i kishte nënshkruar me BERZH-in në vitin 2016, e garantuar edhe nga Qeveria, një nga kushtet për disbursimin e objektit është marrëveshja e planit format të shlyerjes midis KESH-it dhe OSHEE-së për të arkëtueshmet e papaguara.

Më 20 prill 2018, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në përputhje me Pikën 9.01 dhe Termat dhe Kushtet Standarde të Marrëveshjes së Kredisë dhe Marrëveshjes së Garancisë të ratifikuar me Ligjin Nr. 125 / 2016 "Për Projektin: Shqipëria: Plani i ristrukturimit të KESH-it", informoi KESH sh.a. për bërjen efektive të kredisë së dhënë në kuadër të kësaj marrëveshjeje, duke filluar nga data e marrjes së informacionit. Mbështetur në dispozitat e marrëveshjes së mësipërme, Pika 2.02 (g), duke e bërë efektive marrëveshjen e njoftuar, u disbursua kësti i parë prej 118 milionë Euro, gjatë periudhës qershor - korrik 2018. Ky këst mbulon disa nga overdraftet që KESH sh.a ka në bankat tregtare dhe do të ristrukturojë strukturën aktuale të overdraftit, që KESH sh.a ka në bankat tregtare të Shqipërisë, duke i shlyer plotësisht.

Grupi beson se të dhënat e disponueshme vazhdojnë të tregojnë se ekspozimi ndaj OSHEE-së nuk është zhvlerësuar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Të arkëtueshmet duhet të zhvlerësohen për të gjitha shumat që Grupi i përcakton si shuma që mund të mos mbliidhen sipas termat kontraktuale të marrëveshjes/marrëveshjeve.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet profili i riskut të llogarive dhe të arkëtueshmeve të tjera mbështetur në matricën e provizioneve të Grupit. Duke qenë se përvoja e mëparshme e Grupit me humbjet nuk tregon modele domethënëse të humbjeve për segmente të ndryshme klientësh, provizioni mbështetur në statusin e vonuar nuk bën dallim midis bazave të ndryshme të klientëve të Grupit për subjekte private. Në lidhje me situatën e OSHEE sh.a dhe OST sh.a, vlerësimi ishte individual.

Zhvlerësimi (vazhdim)

Të arkëtueshmet nga tregtia, me përjashtim të OSHEE-së dhe OST-së, më 31 dhjetor 2020

Përcaktimi i humbjeve të pritshme	më pak se 365 ditë të papaguara	Mbi 365 ditë të papaguara
Gjendja e papaguar në datën e raportimit	658,206	35,880
Normat e humbjeve të pritshme të kreditit	14%	45%
Provizionet për humbjet e mundshme të kreditit	92,751	16,146

Të arkëtueshmet nga tregtia, me përjashtim të OSHEE-së dhe OST-së, më 31 dhjetor 2019

Përcaktimi i humbjeve të pritshme	më pak se 365 ditë të papaguara	Mbi 365 ditë të papaguara
Gjendja e papaguar në datën e raportimit	3,047	267,319
Normat e humbjeve të pritshme të kreditit	18%	45%
Provizionet për humbjet e mundshme të kreditit	548	120,294

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA DHE DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.1 Risku i kredisë (vazhdim)

Llogaritë e arkëtueshme të OSHEE-së dhe OST-së, më 31 dhjetor 2020

	Monedha	Vlerësimi i Moody-t*	Faza e klasifikimit	EAD-ja në valutën vendase	Humbje të pritshme (12 mos) në valutën vendase
OSHEE (fatura aktuale)	Lekë	B1	Stadi 1	8,363,905	12,546
OSHEE (borxh i vjetër)	Lekë	B1	Stadi 1	48,628,509	72,943
OST	Lekë	B1	Stadi 1	4,644,490	6,967
Gjithsej				61,636,904	92,456

Llogaritë e arkëtueshme të OSHEE-së dhe OST-së, më 31 dhjetor 2019

	Monedha	Vlerësimi i Moody's*	Faza e klasifikimit	EAD-ja në valutën vendase	Humbje të pritshme (12 mos) në valutën vendase
OSHEE (fatura aktuale)	Lekë	B1	Stadi 1	2,159,944	3,240
OSHEE (borxh i vjetër)	Lekë	B1	Stadi 1	51,222,574	83,329
OST	Lekë	B1	Stadi 1	4,296,376	7,293
Gjithsej				57,678,894	93,862

* Vlerësimi i qeverisë shqiptare nga Moody's

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020

Përcaktimi i humbjeve të pritshme	më pak se 365 ditë të papaguara	1- 2 vjet Të papaguara	Mbi 2 vjet të papaguara
Gjendja e papaguar në datën e raportimit	48	20,657	2,007,264
Normat e humbjeve të pritshme të kreditit	1%	27%	83%
Provizionet për humbjet e mundshme të kreditit	0	5,577	1,661,225

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2019

Përcaktimi i humbjeve të pritshme	më pak se 365 ditë të papaguara	1 - 2 vjet të papaguara	Mbi 2 vjet të papaguara
Gjendja e papaguar në datën e raportimit	3,046	254,699	-
Normat e humbjeve të pritshme të kreditit	18%	45%	100%
Provizionet për humbjet e mundshme të kreditit	548	114,615	-

Zhvlerësimi (vazhdim)

Në tabelën e mëposhtme ofrohen informacione rreth ekspozimit bruto ndaj riskut të kredisë dhe hapësirave për humbje nga zhvlerësimi për tregtinë dhe të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	Vlera kontabël bruto	Hapësirat për humbje nga zhvlerësimi	Vlera kontabël neto
31 dhjetor 2020			
Familje	40,627,892	(40,627,892)	-
Të arkëtueshme tregtare nga OSHEE-ja	56,992,414	(84,380)	56,908,034
Të arkëtueshme tregtare nga OST-ja	4,644,490	(8,075)	4,636,415
Të arkëtueshme tregtare nga FSHU-ja	645,803	-	645,803
Klientë të tjerë	112,583	(108,897)	3,686
Të arkëtueshme në lidhje me çështjen e SHKEE	862,121	(862,121)	-
Të arkëtueshme të lidhura me çështjen Jacobsen	168,173	(168,173)	-
Të arkëtueshme tatimi mbi të ardhurat	542,741	-	542,741
Të arkëtueshme të tjera	2,027,969	(1,666,802)	361,167
Gjithsej	106,624,186	(43,526,340)	63,097,846

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA DHE DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.1 Risku i kredisë (vazhdim)

31 dhjetor 2019	Vlerë kontabël bruto	Hapësirat për humbje nga zhvlerësimi	Shuma kontabël neto
Familje	40,627,892	(40,627,892)	-
Të arkëtueshme tregtare nga OSHEE-ja	53,382,518	(86,569)	53,295,949
Të arkëtueshme tregtare nga OST-ja	4,296,376	(7,293)	4,289,083
Të arkëtueshme tregtare nga FSHU-ja	-	-	-
Klientë të tjerë	160,489	(120,842)	39,647
Të arkëtueshme në lidhje me çështjen e SHKEE	862,121	(862,121)	-
Të arkëtueshme të lidhura me çështjen Jacobsen	168,173	(168,173)	-
Të arkëtueshme tatimi mbi të ardhurat	-	-	-
Të arkëtueshme të tjera	4,615,725	(115,163)	4,500,562
Gjithsej	104,113,294	(41,988,053)	62,125,241

Grupi përcakton një hapësirë për humbjet nga zhvlerësimi që përfaqëson vlerën e humbjeve të pësuar në portofolin e tij.

Lëvizjet në hapësirën për humbjet nga zhvlerësimi për sa i përket të arkëtueshmeve tregtare dhe të arkëtueshmeve të tjera gjatë vitit janë si vijon:

	2020	2019
Bilanci më 1 janar	41,988,053	41,225,530
Rregullime për vitet e shkuara (Shënim 11.6)	1,158,839	-
Humbjet e njohura nga zhvlerësimi	392,800	2,186,520
Rimarrje nga zhvlerësimi	(13,352)	(1,423,997)
Bilanci deri më 31 dhjetor	43,526,340	41,988,053

Që nga 31 dhjetori 2020, shuma prej 43,526,340 mijë Lekë (2019: 41,988,053 mijë Lekë) e lidhur me bilancin e të arkëtueshmeve nga klientët nga familjet për faturat e papaguara për energjinë elektrike që përpara kalimit të KESH në OSHEE, që Grupi nuk pret t'i mbledhë. Pjesa e mbetur e shumës rezervë për zhvlerësimin që nga 31 dhjetori 2020 dhe 2019 është e lidhur me bilancin e të arkëtueshmeve afatgjata që nuk mendohet se do të mbledhen.

Politika e shlyerjeve

Grupi shlyen bilancin e të arkëtueshmeve (dhe të gjitha hapësirat për humbjet nga zhvlerësimi) kur menaxhimi vendos që të arkëtueshmet janë të pa arkëtueshme. Vendimi merret pasi është marrë në konsideratë informacioni për përpjekjet e konsiderueshme që janë bërë për të rikuperuar shumën dhe nëse nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e bilancit të pashlyer.

5.2.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risku i humbjeve si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut vendas (çmimet e ulura të shitjes së energjisë elektrike), kursit të këmbimit të monedhave të huaja, normave të interesit dhe çmimeve të kapitalit. Niveli i riskut të tregut ndaj të cilit është ekspozuar Grupi në një moment në kohë varet nga kushtet e tregut, pritshmëritë për çmimin ose lëvizjet e ardhshme të tregut dhe përbërjes së aktiveve fizike të Grupit dhe portofolit të kontratës.

Risku i këmbimit valutor

Risku i kursit të këmbimit vjen nga fakti se të ardhurat e Grupit dhe pjesa më e madhe e huave dhe të arkëtueshmeve të tij janë në LEK, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e huave dhe të pagueshmeve tregtare të Grupit për importin e energjisë janë në monedhë të huaj (duke përfshirë EUR, USD, CHF dhe KRW). Risku qëndron në faktin që vlera funksionale e fluksit të mjeteve monetare vjen si rrjedhojë e pagimit të borxheve, me interesin dhe pagesat e energjisë së importuar variojnë si rezultat i lëvizjeve në kursin e këmbimit, që ndikon veçanërisht në fitimet e Grupit. Për të optimizuar qëllimin e kostove financiare, në raste të caktuara, Grupi ka marrë hua fonde në monedha të huaja, kryesisht në USD, EUR, dhe YEN.

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.2 Risku i tregut (Vazhdim)

Tabela më poshtë përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare dhe përmbledh ekspozimin e Grupit ndaj riskut të kursit të këmbimit të monedhës së huaj në datën e raportimit:

	2020			2019		
	Aktive monetare financiare	Detyrimet monetare financiare	Pozicioni i balancës neto	Aktive monetare financiare	Detyrimet monetare financiare	Pozicioni i bilancit neto
LEK	65,299,741	10,592,398	54,707,343	59,969,343	31,558,319	28,410,024
EUR	10,632,817	55,442,390	(44,809,573)	13,866,701	45,400,303	(31,533,602)
USD	1,288,308	7,413,056	(6,124,748)	2,013,666	7,558,885	(5,545,219)
YEN	2,732,566	2,831,263	(98,697)	2,615,810	2,789,955	(174,145)
CHF	947,852	1,997,891	(1,050,039)	895,772	2,184,147	(1,288,375)
Të tjera	2,732,869	2,652,535	80,334	2,117,824	2,588,501	(470,677)
Gjithsej	83,634,153	80,929,533	2,704,620	81,479,116	92,080,110	(10,600,994)

Kursi i këmbimit i përdorur për të kthyer aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si vijon:

<i>Në Lek:</i>	2020	2019
EUR	123.70	121.77
USD	100.84	108.64
CHF	114.46	112.3
100 YEN	0.9788	1.0009

Menaxhimi i riskut të këmbimit valutor plotësohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit për skenarë të ndryshëm standard dhe jo standard për kursin e këmbimit. Skenarët standard të marrë rregullisht në konsideratë përfshijnë një rënie ose ngritje paralele me 100 pikë bazë (bp) në të gjithë kurset e këmbimit.

Analiza e ndjeshmërisë së Grupit ndaj rritjes apo uljes së vlerës së Lekut kundër monedhave të huaja (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike dhe pozicionin e deklarimit të vazhdueshëm financiar) është si vijon:

	2020		2019	
Efekti i fitimit/humbjes së vlerësuar	100 bp rritje	100 bp ulje	100 bp rritje	100 bp ulje
EUR	(644,480)	644,480	(315,336)	315,336
USD	(85,241)	85,241	(55,452)	55,452
YEN	(55,679)	55,679	(1,741)	1,741
CHF	(38,912)	38,912	(12,884)	12,884
KRW	(53,891)	53,891	(4,707)	4,707

Risku i normës së interesit

Në rrjedhën normale të punës, Grupi merr hua për të financuar operacionet e tij. Grupi është i ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit, sepse vlera e drejtë e huave me normë fikse dhe fluksi i mjeteve monetare i lidhur me huatë e normës së ndryshueshme luhaten dhe do të ketë ndryshime në normën e interesit. Shënimi 12 shtjellon normat e interesit për huatë e Grupit.

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDI)**5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****5.2.2 Risku i tregut (vazhdim)**

Profili i normës së interesit për instrumentet financiarë me interes si i raportohet menaxhimit të Grupit është si vijon:

	2020	2019
Instrumente me normë fikse		
Aktive financiare të arkëtueshme	14,801,510	14,157,354
Huatë	(39,048,705)	(50,855,130)
Instrumente totale me normë fikse	(24,247,195)	(36,697,776)
Instrumente me normë të ndryshueshme		
Aktive financiare të arkëtueshme	4,688,338	4,211,047
Huatë	(41,881,241)	(28,754,267)
Instrumente totale me normë të ndryshueshme	(37,192,903)	(24,543,220)

Një ndryshim i arsyeshëm i mundshëm me 100 pikë bazë në normën e interesit në datën e raportimit do ta shtonte (ulte) përfitimin me shifrat e treguara më poshtë. Analiza supozon se të gjitha ndryshoret, në veçanti normat e këmbimit të monedhave të huaja do të mbeten konstante.

	2020		2019	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
Efekti i fitimit/humbjes së vlerësuar	458,030	(458,030)	552,437	(552,437)

Risku i çmimit në tregje të tjera - çmimet e energjisë

Sipas rregullave të modelit të ri të tregut (Shënimi 1), KESH ushtron rolin e gjenerimit të energjisë elektrike, që kërkon që Grupi të furnizojë OSHEE-në me një sasi të caktuar energjie elektrike për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve të rregulluar me tarifa përfundimtare, me një çmim të dakorduar mes palëve, objekt miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Kjo sasi do të dakordohet në kontratën e rregulluar mes palëve, objekt miratimi nga ERE dhe do të përcaktohet bazuar në nivelet e prodhimit mesatar historik të KESH-it, duke supozuar një regjim racional të shfrytëzimit të kapaciteteve të tij gjeneruese. Nëse KESH nuk do të jetë në gjendje të furnizojë OSHEE me sasinë e miratuar, kjo e fundit do ta blejë këtë sasi në tregun e parregulluar dhe KESH do të kompesojë OSHEE-në për energjinë që nuk i ka furnizuar me çmimin e rregulluar, që është çmimi i miratuar nga ERE dhe i dakordësuar mes KESH-it dhe FSHU-së. Tepëricat e prodhimit mbi sasinë e miratuar për OSHEE-në do t'i jepen OSHEE-së për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes, me çmimin referencë të tregut. Çmimi i referencës i tregut është çmimi i Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX) sikurse është përcaktuar në marrëveshjen për furnizimin midis KESH dhe FSHU.

Për periudhën janar-dhjetor 2020, MIE vendosi se çmimi për shitjen e energjisë elektrike nga KESH sh.a. në OSHEE sh.a. është 1.5 Lek/kWh, vendimi nr. 10841/1, 27 dhjetor, 2019.

Duke marrë parasysh që Grupi mund të mos jetë në gjendje të furnizojë OSHEE-në me sasinë e rregulluar me kapacitetet e tij të gjenerimit, ose mund të ketë mbiproduhim mbi atë sasi, Grupi mbetet i varur nga tregjet rajonale me shumicë të energjisë elektrike, që kanë qenë të paqëndrueshëm vitet e fundit. E ardhmja për vitin 2020 vazhdon të mbetet e vështirë për t'u parashikuar, pjesërisht për shkak të ambientit të pasigurt ekonomik si dhe për shkak të ndikimit të COVID-19 dhe ngjarjeve gjeopolitike.

Paqëndrueshmëria klimatike si dhe risku hidrik që është gjithnjë i pranishëm në operacionet e KESH-it, veçanërisht me pasiguritë e regjimeve të brezave të ardhshëm dhe mundësia për të tregtuar tepëricën e energjisë, pengon llogaritjen e parashikimeve të besueshme për të mbështetur vendimet e investimeve që çojnë në kthime potencialisht më të ulëta se sa pritej.

Për shkak të paqëndrueshmërisë të klimës, Grupi është ekspozuar gjithnjë e më shumë në pozicione ku aftësitë e tij për gjenerimin e energjisë elektrike nuk mund të ofrohen sipas detyrimeve të shërbimit publik, duke qenë se kërkesa për konsum nga FTL-ja në nivelet e tij të ulëta gjatë periudhave të vërshimit dhe niveleve më të larta në kaskadë. Ky pozicion i kundërt erdhi në sistemin e energjisë për shkak të varësisë dhe ndjeshmërisë së lartë të sistemit të hidrologjisë. Duke qenë se 98% e kapaciteteve të instaluar të gjenerimit në Shqipëri janë hidrike, i gjithë sistemi është i ekspozuar në rast thatësire ose në të njëjten mënyrë edhe ndaj sezonit të reshjeve.

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)**5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****5.2.2 Risku i tregut (vazhdim)**

Duke marrë parasysh që në vitin 2020 nuk ka pasur asnjë ngjarje metrologjike të rëndësishme, për shkak të ngjarjeve ekstreme të përjetuara nga Grupi në vitet e mëparshme, menaxhimi nëpërmjet rezervimit të gjenerimit të vërshimeve të larta në kushtet kur nevoja për furnizim ose çmimi i tregut është e ulët dhe shoqëria bazohet në një PSO që në rast mospërputhje do ta detyrojë shoqërinë të kompesojë, e ekspozon shoqërinë ndaj risqeve komerciale dhe financiare që duhen adresuar.

Për të menaxhuar këtë risk Grupi optimizon portofolin e aktiveve dhe kontratave të tij nëpërmjet një qasje të bazuar në një analizë të gjerë të furnizimit dhe kërkesës dhe vlerësimit të vazhdueshëm të tregjeve vendase në të cilat operojnë. Grupi, në rolin e tij si shitës në treg është i ekspozuar ndaj riskut të çmimit të energjisë në sigurimin e energjisë dhe veprimtaritë e lidhura për shkak se kostoja e sigurimit të energjisë për t'i shërbyer konsumatorëve mallra me çmim shumice. Risku kryesor është që çmimet e energjisë në treg do të luhaten midis momentit kur çmimet e shitjes ishin fikse ose kur ishin vendosur tarifat dhe në momentin kur janë vendosur kostot përkatëse të sigurimit, mundësisht duke zvogëluar margjinat e pritshme ose duke i bërë shitjet më pak fitimprurëse.

Kosovë

Marrëveshja e Shkëmbimit të Energjisë Elektrike midis KESH dhe Koorporatës së Energjisë së Kosovës ("KEK") e ka origjinën e saj për një kohë të gjatë. Bazohet në angazhimin e përbashkët për të shkëmbyer energji elektrike sipas nevojës nga njëra palë dhe gatishmëria për të marrë nga pala tjetër.

Situata kur ndodh një shkëmbim lidhet ose me momentin kur KESH ka prurje të mëdha ujore ose kur KEK ka defekte në njësitë e veta të prodhimit të energjisë. Një marrëveshje e tillë për shkëmbimin e energjisë elektrike bazohet në tiparet plotësuese të dy sistemeve. Shqipëria mbështetet në prodhimin e energjisë nga burimet hidrike, ndërsa Kosova mbështetet në prodhimin e energjisë nga burime të djegjshme. Megjithatë, të dy shoqëritë kanë përparësitë e tyre lidhur me detyrimet përkatëse të shërbimit publik në tregjet kombëtare. Gjatë vitit 2020, KESH ka marrë nga KEK 29.519 MWh dhe ka kthyer 26.386 MWh. Një pjesë e energjisë elektrike të marrë ishte pjesë e një bilanci të pashlyer nga viti 2018, kur KESH i kishte dhënë energji elektrike KEK gjatë pranverës.

Shkëmbimi i energjisë mes dy gjeneratorëve ka për synim të lehtësojë aftësinë e tjetrit për të përmbushur kërkesat e tregut për energji dhe nuk është një transaksion me substancë ekonomike. Si rezultat, asnjë e ardhur nuk mbledhet gjatë këtyre shkëmbimeve.

Analiza e ndjeshmërisë

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2020, një rritje (ulje) prej 10% në çmimin e energjisë, ndërkohë që të gjitha ndryshoret e tjera mbeten konstante do të rrisë/(ulë) të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike nga 599,765 mijë (2019: 690,793 mijë Lekë).

5.2.3 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit përkufizohet si risku që enti do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare. Grupi ekspozohet ndaj thirrjeve ditore ndaj burimeve të disponueshme për mjetet monetare, kryesisht për të zgjidhur shpenzimet operative gjatë veprimtarisë së tij të zakonshme, si dhe për të paguar borxhin e tij. Nga ana tjetër, Grupi përballet me vonesa substanciale në zgjidhjen e shitjes së krediteve të OSHEE-së. Menaxhimi monitoron çdo muaj parashikimin për fluksin e mjeteve monetare të Grupit.

Procesi i likuiditetit të menaxhimit i miratuar nga menaxhimi përfshin vendosjen e kufijve për njësi për shpenzimet e lidhura me veprimtaritë ditore si shërbimet, furnizimet, investimet, shtyrjen e pagesave të furnitorëve, riprogramimi i marrëveshjeve mes palëve, programimi i pagesave të borxheve duke garantuar mbulimin e tyre. Tabela e mëposhtme tregon detyrimet financiare në datën e raportimit sipas maturitetit të tyre kontraktual të mbetur.

5. INSTRUMENTET FINANCIARE - VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.3 Risku i likuiditetit (vazhdim)

Shumat e shpalosura në tabelën e maturimit janë flukset monetare të skontuara kontraktuale,

	Deri në 1 vit	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
2020				
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	14,493,977	-	-	14,493,977
Huatë	40,580,926	16,139,444	24,209,166	80,929,535
Gjithsej	55,074,903	16,139,444	24,209,166	95,423,512

	Deri në 1 vit	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
2019				
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	12,470,715	-	-	12,470,715
Huatë	52,674,574	15,094,823	11,840,000	79,609,397
Gjithsej	65,145,289	15,094,823	11,840,000	92,080,112

Data e pritshme e zgjidhjes së detyrimeve mund të ndryshojë shumë nga maturimi kontraktual. Duke qenë se shumica e huamarrjeve i detyrohen qeverisë, Grupi pret që shlyerja të ndodhë në afatin kohor të rënë dakord reciprokisht pasi të plotësohen nevojat e fluksit të mjeteve monetare të operacioneve të tij.

5.3 Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Grupit gjatë menaxhimit të kapitalit janë mbrojtja e aftësisë së tij për të vijuar me punën dhe për të mundësuar kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera të interesit, si dhe ruajtja e një strukture kapitali optimale, me qëllim reduktimin e kostos së kapitalit. Për të ruajtur ose për të përshtatur strukturën e kapitalit, Grupi mund të përshtatë shumën e dividendëve që i paguhen aksionarit, t'iu kthejë aksionarëve kapitalin, të emetojë aksione të reja ose t'i shesë aktivet për të reduktuar borxhin.

5.4 Ndryshimet në detyrime që rrjedhin nga financimi i veprimtarive

Në përputhje me të tjerët në industri, Grupi monitoron kapitalin mbështetur në raportin financiar krahasues. Ky raport përllogaritet si detyrime totale pjesëtuar me kapital total të drejtimit. Grupi e konsideron kapitalin total të drejtimit të barabartë me kapitalin, që paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Raporti financiar krahasues i Grupit më 31 dhjetor 2020 është 1.147 (31 dhjetor 2019: 1.054).

	1-Jan-2020	Disbursime të reja	Pagesa e principalit	Ndryshimet në FV për disbursime të reja	Të tjera	31-Dec-20
Overdraft (me përjashtim të zërave të poshtërenditur)	18,453,980	8,778,929	(19,257,506)	-	(663,197)	7,312,206
Huamarrje afatshkurtër	34,220,594	1,648,357	(829,544)	(372,267)	(1,398,009)	33,269,131
Huamarrje afatgjatë	26,934,823	12,120,470	-	668,840	624,476	40,348,609
Gjithsej	79,609,397	22,547,756	(20,087,050)	296,573	(1,436,730)	80,929,946

	1-Jan-2019	Disbursime të reja	Pagesa e principalit	Ndryshimet në FV për disbursime të reja	Të tjera	31-Dec-19
Overdraft (me përjashtim të zërave të poshtërenditur)	17,467,808	12,297,258	(11,090,165)	-	(220,921)	18,453,980
Huamarrje afatshkurtër	30,074,704	48,127	(1,289,011)	(148,845)	5,535,619	34,220,594
Huamarrje afatgjatë	29,484,738	770,027	-	(150,872)	(3,169,070)	26,934,823
Gjithsej	77,027,250	13,115,412	(12,379,176)	(299,717)	2,145,628	79,609,397

Kolona "Të tjera" përfshin efektin e riklasifikimit të pjesës afatgjatë të huave dhe huamarrjeve me interes në afatshkurtër për shkak të kalimit të kohës, çdo efekt të shkëmbimeve të huaja të gjendjeve të papaguara në fund të periudhës së raportimit, dhe efektin e interesit të mbledhur, por ende të papaguar të huave dhe huamarrjeve me interes. Grupi e klasifikon interesin e paguar si fluks të mjeteve monetare nga veprimtaritë operative.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Kosto ose vlerësim	Tokë	Godinat	Makineritë dhe pajisjet	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Ndërtimi në proces e sipër	Gjithsej
Më 1 janar 2019	1,614,925	92,041,912	47,376,704	387,771	366,586	9,490,221	151,278,119
Shtesa	-	118,315	178,572	6,803	28,928	2,004,212	2,336,830
Dalje	(398,556)	(2,582)	(10,000)	(1,750)	-	-	(14,332)
Transferimet	1,216,369	167,920	4,715,883	-	-	(4,485,247)	-
Deri më 31 dhjetor 2019	1,216,369	92,325,565	52,261,159	392,824	395,514	7,009,186	153,600,617
Rezerva shesë e rivlerësimit	-	-	-	-	-	-	-
Eliminim i zhvlerësimit të akumuluar	-	-	-	-	-	-	-
Më 1 janar 2020	1,216,369	92,325,565	52,261,159	392,824	395,514	7,009,186	153,600,617
Shtesa	-	899	57,883	748	89,728	1,511,529	1,660,787
Dalje	-	-	(25)	(70)	(13,795)	-	(13,890)
Transferimet	-	1,756,831	219,780	70	18,219	(1,994,900)	-
Më 31 dhjetor 2020	1,216,369	94,083,295	52,538,797	393,572	489,666	6,525,815	155,247,514
Kosto neto e zhvlerësimit							
Më 1 janar 2019	1,614,925	84,162,693	42,966,412	361,057	349,236	8,940,135	138,394,458
Më 31 dhjetor 2019	1,216,369	92,325,564	52,261,158	392,824	395,514	7,009,187	153,600,616
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 janar 2019	-	(43,146,164)	(21,997,855)	(193,041)	(196,866)	22,793	(65,511,133)
Detyrimi për periudhën	-	(1,664,237)	(1,813,790)	(18,620)	(51,006)	-	(3,547,653)
Rimarrje	-	-	400	-	(352)	-	48
Deri më 31 dhjetor 2019	-	(44,810,401)	(23,811,245)	(211,661)	(248,224)	22,793	(69,058,738)
Sistemim në Amortizimin e akumuluar	-	(277,878)	(14,678)	-	-	-	(292,556)
Më 1 janar 2020	-	(45,088,279)	(23,825,923)	(211,661)	(248,224)	22,793	(69,351,294)
Shpenzimi amortizimit për periudhën	-	(1,750,423)	(1,804,085)	(17,383)	(56,301)	-	(3,628,192)
Rimarrje	-	-	-	-	3,537	-	3,537
Më 31 dhjetor 2020	-	(46,838,702)	(25,630,008)	(229,044)	(300,988)	22,793	(72,975,949)
Vlera neto							
Më 1 janar 2019	1,614,925	41,016,529	20,968,557	168,016	152,370	8,962,928	72,883,325
Deri më 31 dhjetor 2019	1,216,369	47,515,164	28,449,914	181,163	147,290	7,031,979	84,541,879
Më 1 janar 2020	1,216,369	47,237,286	28,435,236	181,163	147,290	7,031,979	84,249,323
Më 31 dhjetor 2020	1,216,369	47,244,593	26,908,789	164,528	188,678	6,548,608	82,271,565

Nëse do të ishte përdorur modeli i koston, vlera kontabël neto që përfaqëson koston e supozuar si pasojë e tranzicionit në SNRF të aktiveve afatgjatë materiale më 31 dhjetor 2020 dhe do të ishte 34,911 milionë Lekë (2019: 46,100 milionë Lekë). Shumat e rivlerësuar përfaqësojnë një sifitë rivlerësimi i cili nuk mund t'i shpërndahet aksionarit. Transferimet kryesish janë ndërtime në proces të përfunduar gjatë vitit dhe të transferuara në aktive të disponueshme për përdorim.

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)**(i) Matja e vlerës së drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë**

Në 2019, Grupi ka rivlerësuar vlerën e drejtë të aktiveve afatgjata materiale duke rezultuar me një rritje neto prej 1,568,490 mijë Lekë.

Aktivët afatgjata materiale që lidhen me TEC Vlorë, me një vlerë kontabël prej 7,770, 262 mijë lek më 31 dhjetor 2020 (2019: 8,353,835 mijë lek), nuk ishin pjesë e procesit të rivlerësimit dhe nuk ishin rivlerësuar gjatë vitit 2020.

Vlera e drejtë e aktive afatgjata materiale u përcaktua nga një grup me gjashtë ekspert të jashtëm të caktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Grupi i ekspertëve përbëhet nga 3 vlerësues të certifikuar të pasurive të paluajtshëm dhe kontabilistë të miratuar. Raporti është miratuar nga Pronari më 11 shtator 2020, ndërsa data efektive e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale të Grupit është 1 janar 2019. Rivlerësimi është kryer në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Vlerësimit.

Niveli 3 i vlerës së drejtë

Vlerat e drejta të aktiveve afatgjata materiale të Grupit kategorizohen në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Të dhënat e rëndësishme dhe supozimet zhvillohen me bashkëpunimin e ngushtë të drejtimit.

Tabela më poshtë tregon teknikat e vlerësimit në matjen e vlerës së drejtë të aktiveve afatgjata materiale si edhe të dhënat e rëndësishme të pa-vëzhgueshme të përdorur.

Asetet	Teknika e vlerësimit	Të dhënat e rëndësishme të pavëzhgueshme
Tokë	Qasja në Treg - Metoda e krahasimit të shitjeve; - Metoda e zhvillimit; - Metoda e alokimit;	Çmimet e tregut janë rregulluar për të marrë në konsideratë: Veprimtarinë e ulët në treg dhe mungesën e pronave të krahasueshme në shitje;
Godinat	Qasja në Treg - Metoda e krahasimit të shitjeve; Qasja e të Ardhurave - Metoda e kapitalizimit të drejtpërdrejtë dhe Qasja e Kostos - Metoda e kostos së zëvendësimit të zhlerësuar	Çmimet e tregut janë rregulluar për të marrë në konsideratë: - Veprimtarinë e ulët në treg dhe mungesën e pronave të krahasueshme në shitje; - Gjendja specifike e çdo prone (ndërtimi, pozicioni, etj.) Përdorimi i kufizuar i pronave në varësi të llojit të godinës, pra, godinë administrative apo prodhimi.
Makineri dhe pajisje	Qasja e kostos Metoda e kostos së zëvendësimit të zhvlerësuar	Përcaktimi i vlerës së drejtë është tejet subjektiv për shkak të: - Natyres së specializuar të aktiveve dhe mungesës së veprimtarisë në treg. - Gjendjes specifike të secilit aktiv, përfshirë ciklet e parashikuar të jetës, në varësi të shkallës së mirëmbajtjes dhe kushteve të tjera të tregut
Automjete transporti, mobilie zyre, dhe pajisje TI-je	Qasja në Treg - Metoda e krahasimit të shitjeve; Qasja e kostos - Metoda e kostos së zëvendësimit të zhvlerësuar	Çmimet e tregut janë rregulluar për të marrë në konsideratë: - Mungesë veprimtarie në treg për aktive të krahasueshme. - Kushte specifike për çdo aktiv.

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)**(ii) Testi i zhvlerësimit*****Testi i zhvlerësimit më 31 dhjetor 2020***

Siç përshkruhet më lart, vlera e drejtë e pjesës më të madhe të aktiveve afatgjata materiale të Grupit, për shkak të natyrës së tyre specifike, është përcaktuar bazuar në metodën e "Kostos së Re të Amortizuar të Zëvendësimit, pjesë e Qasjes së Kostos. Për këtë qëllim, Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 36 ("SNK 36") thekson se "një entitet duhet të vlerësojë në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë indikacion nëse aktivet janë zhvlerësuar. Nëse ekzistojnë të dhëna të tilla, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit.

Shuma e rikuperueshme është vlera me e lartë midis Vlerës në Përdorim dhe Vlerës së Drejtë minus Kostot e Shitjes. Vlera e Drejtë bazohet në Qasjen e të Ardhurave, specifikisht në metodën e Mjeteve Monetare të Skontuara, ndërsa Vlerës së Drejtë minus Kostot e Shitjes bazohet si në Qasjen e të Ardhurave ashtu edhe në Qasjen e Tregut.

Referuar indikacioneve të SNK 36, Grupi realizoi testin e zhvlerësimit për aktivet afatgjata materiale që ishin subjekt rivlerësimi dhe vlerësoi shumën e tyre të rikuperueshme më 31 dhjetor 2020.

Aktivitet afatgjata materiale të TEC Vlorë nuk u testuan për zhvlerësim në 2018 dhe 2019. TEC-i i Vlorës u ndërtua në vitin 2011, me një kapacitet të instaluar prej 98 MW, për të rritur dhe diversifikuar burimet e prodhimit të energjisë elektrike të vendit. Projekti u financua nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.), Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Evropiane e Investimeve (EIB), me një vlerë totale investimi prej rreth 130 milionë euro.

Aktualisht, për shkak të kostove të larta të prodhimit dhe disa problemeve teknike, aktiviteti gjenerues është në kushte konservimi dhe nuk është operativ. Prandaj, bazuar në të dhënat e Shoqërisë, si dhe duke konsideruar faktin se ky aktiv po nxirret jashtë përdorimit, u pa e arsyeshme që TEC Vlorë të përjashtohet nga Testi i Zhvlerësimit. Megjithatë jo në përdorim, TEC Vlorë është zhvlerësuar sipas normës së zhvlerësimit të përfshirë në shënimin 4e. Pas zhvillimit të Shoqërisë dhe zbatimit të modelit të tregut, Drejtuesit kanë vendosur ta ndryshojnë strukturën e CGU-së nga tre CGU të pavarur (secili HEC ishte një CGU) në një njësi të gjenerimit të parasë për arsye të mëposhtme:

a) Faktorët e brendshëm

Investimet e ardhshme të Shoqërisë, që përfshijnë ndërtimin e HEC-it të Skavicës dhe parkun fotovoltai në Kaskadën e Lumit Drin pritet të diversifikojnë prodhimin e energjisë dhe të mundësojnë përdorim më të mirë të burimeve të ujit (kapaciteti i menaxhimit të burimeve ujore pritet të rritet me 20%). Ky përmirësim në menaxhimin e ujit do të forcojë ndërlidhjen ekzistuese të HEC-eve, që pritet ta bëjë pavarësinë e tyre më pak të dukshme.

Për shkak të ndërvlerësimit të tre njësive të HEC-eve nga rezervuari i HEC-it të Fierzës, kaskada menaxhohet për të maksimizuar prodhimin e përgjithshëm në vend të prodhimit të secilës njësi.

b) Faktorët e jashtëm

Pritet që faza e dytë e zbatimit të modelit të tregut të fillojë në vitin 2022, kur bizneset e lidhura në tensionin 20, 10 ose 6 kV do të bëhen pjesë e tregut (rreth 1 TWh). Mundësia e KESH-it për të ofruar energji në termat e tregut, përveç të qenit përfitues mjaft i lartë (duke qenë se çmimi i tregut të energjisë është ndjeshëm më i lartë krahasuar termat kontraktuale aktuale), kërkon koordinim më të mirë dhe menaxhim të riskut të biznesit për shkak të pasigurisë për të hyrë në treg. Që Shoqëria të ketë një koordinim efektiv, njësitet e saj të biznesit (HEC-et) duhet të konsiderohen si njësi të vetme. Gjithashtu, duke qenë se të ardhurat e gjeneruara nga shkalla në çmimet e tregut të hapur bëhen të konsiderueshme ndaj të ardhurave të përgjithshme aktualisht pothuajse tërësisht me çmim të rregulluar, bëhet jo praktikë për Kompaninë që të alokojë të ardhura për secilën njësi gjeneruese të parasë në tarifën aktuale të shitjes ose në çmimin e tregut.

Po ashtu, në vitin 2020, Shqipëria dhe Kosova nënshkruan marrëveshjen për bashkimin e tregut ndërmjet dy shteteve, duke krijuar në këtë mënyrë një shkëmbim të përbashkët energjie (konkretisht ALPEX). Ky bashkëpunim është pjesë e bashkimit të tregut panevropian, që synon transparencë dhe konkurrencë më të lartë në tregun e energjisë.

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)**(ii) Testi i zhvlerësimit (vazhdim)***Testi i zhvlerësimit më 31 dhjetor 2020 (vazhdim)***b) Faktorët e jashtëm (vazhdim)**

Njësoj si implikimet e modelit të tregut, KESH-i duhet të përqendrohet te koordinimi më i ngushtë ndërmjet njësive të biznesit, duke ulur rrjedhimisht pavarësinë e tyre. Në bazë të faktorëve më sipër, KESH-i mund të menaxhojë burimet ujore dhe impiantin e tij diellor, në mënyrë të tillë që të prodhojë energji gjatë intervaleve kohore dhe nga HEC-et mund të marrë çmimin më të avantazhuar të energjisë. Prandaj, për qëllime të testit të zhvlerësimit, KESH-i do të konsiderohet si njësi e vetme.

Në rastin aktual, duke marrë parasysh specifikat e veprimtarisë operuese të Grupit, Drejtuesit kanë gjykuar se shuma e rikuperueshme paraqitet vetëm nga Vlera në Përdorim në këtë Test Zhvlerësimi.

Pas analizës së testit të zhvlerësimit, Vlera në Përdorim llogaritet bazuar në fluksin e ardhshëm të zbritur të mjeteve monetare që do të krijohen nga përdorimi i vazhduar i CGU-së.

Supozimet kryesore që përdoren në vlerësimin e Vlerës në Përdorim janë si më poshtë:

- Vlerësimi i flukseve të zbritura të mjeteve monetare bazohet te një model zbritjeje me tre faza, i cili përfshin (i) një periudhë specifike të parashikuar prej 5 vitesh, (ii) një periudhë ekstrapolimi 4-vjeçare për të pasqyruar zbatimin e modelit të tregut, dhe (iii) përlllogaritjen e vlerës terminale të Grupit, bazuar në kapitalizimin e flukseve të mjeteve monetare të periudhës terminale.
- Prodhimi i pritshëm i energjisë llogaritet duke marrë në konsideratë prodhimin mesatar historik të 29 viteve (1991-2020), i cili barazohet me 4.3 TWh/vit, me supozimin se do të mbetet konstant gjatë periudhës së parashikuar.
- Në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve aktuale, dhe duke marrë parasysh zbatimin e modelit të ri të tregut (VKM Nr. 519, datë 13.07.2016), total i energjisë i prodhuar nga KESH sh.a. supozohet të shitet pjesërisht në tregun e rregulluar dhe pjesërisht në atë të parregulluar (të lirë).
 - Gjatë dy periudhave të para të parashikuara (2021-2023), pritët që shitjet të bazohen te modeli aktual i tregut, në të cilin KESH-i është i detyruar t'i shesë FSHU-së (OSHEE) 3.95 TWh në vit.
 - Vitet 2024-2026 konsiderohen një periudhë tranzicioni me prezantimin e modelit të ri të tregut, ku detyrimi i KESH-it ndaj FSHU-së (OSHEE) pritët të ulët ndjeshëm në 3.13 TWh.
 - Nga viti 2027 e në vazhdim, ky detyrim pritët të mbetet i pandryshuar.
- Tarifa e zbatueshme për energjinë e shitur në tregun e rregulluar përcaktohet aktualisht nga autoritetet qeveritare përkatëse dhe supozohet të pasqyrojë vetëm normën e inflacionit në Shqipëri. Çmimi i energjisë së shitur në tregun e parregulluar bazohet te çmimi mesatar HUPX dhe supozohet se pasqyron vetëm normën e inflacionit të Eurozonës dhe kursin e këmbimit Lekë/Euro.
- Investimet kapitale të parashikuara për CGU-në bazohen te plani i investimeve të Grupit, të marra nga Programi Financiar dhe Ekonomik, i cili është rregulluar më pas për të përjashtuar çdo investim jo drejtpërdrejt të lidhur me aktivet në shqyrtim, si dhe çdo investim të një natyre shpenzimesh dhe më vonë është normalizuar për të pasqyruar prirjen historike të realizueshmërisë.
- Kostot operative të parashikuara për CGU-në bazohen te plani i investimeve i Grupit, të marra nga Programi Financiar dhe Ekonomik, dhe, në sajë të natyrës së tyre fikse, pritët të pasqyrojnë një prirje rritëse të qëndrueshme, duke reflektuar vetëm normën e inflacionit.
- Kapitali qarkullues i aplikuar bazohet te të dhënat historike të Grupit, që më pas janë rregulluar për të përjashtuar çdo efekt që nuk lidhet drejtpërdrejt me punën normale të Grupit.
- Norma e Zbritjes (WACC) llogaritet bazuar në koston e kapitalit në termat e tregut të Grupit dhe kostoja e borxhit bazuar në normat e tregut (publikuar nga Agjencitë Ndërkombëtare Huadhënëse nën një Garanci Sovrane) në Datën e Testit të Zhvlerësimit. Për më tepër, Norma e Zbritjes përfshin edhe shqyrtimin e risqeve të industrisë dhe të risqeve specifike të Grupit, që më pas përdoren për të zbritur flukset e mjeteve monetare.

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)**(ii) Testi i zhvlerësimit (vazhdim)***Testi i zhvlerësimit më 31 dhjetor 2020 (vazhdimi)***b) Faktorët e jashtëm (vazhdim)**

- Shuma e flukseve të mjeteve monetare të zbritura rregullohen më pas duke zbritur bilancin e kapitali qarkullues në secilën periudhë raportimi, me qëllim identifikimin e vlerës në përdorim të aktiveve të trupëzuara të CGU-së.

Supozime kryesore të testit të zhvlerësimit - Viti i mbyllur në 2020 si më poshtë:

(Lek'000)

Mesatare e ponderuar e rritjes vjetore		
EBITDA (mesatare e 9 viteve të parashikuara)	%	13.2%
Normat e zbritjes (WACC)	%	10.33%
Norma e rritjes terminale	%	2.0%
Fluksi i mjeteve monetare në periudhën terminale		14,273,462

(iii) Sigurimi

Nuk kishte aktive të lëna peng si kolateral deri më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

(iv) Ndërtimi në proces e sipër

Ndërtimi në proces e sipër përfaqëson ndërtimin e aseteve të papërfunduara ende dhe lidhet kryesisht me mbrojtjen e hidrocentraleve dhe digave.

7. AKTIVE FINANCIARE TË ARKËTUESHME

	2020	2019
Detyrime afatgjata		
Hua ndaj palëve të treta	9,836,230	6,184,688
Huan ndaj punonjësve	8,806	9,553
Provizjon zhvlerësimi	(29,020)	(25,881)
	9,816,016	6,168,360
Detyrime afatshkurtra		
Hua ndaj palëve të treta	9,673,312	12,199,477
Huan ndaj punonjësve	520	564
	9,673,832	12,200,041
Gjithsej	19,489,848	18,368,401

Hua ndaj palëve të treta

Huatë ndaj palëve të treta paraqesin fonde të huazuara fillimisht nga Grupi nga institucione të ndryshme dhe të nënhuazuara subjekteve të mëposhtme:

- OST sh.a në shumën 8,536,068 mijë Lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 7,669,416 mijë Lekë);
- OSHEE sh.a në shumën 10,900,683 mijë Lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 10,612,099 mijë Lekë);
- Huatë ndaj OST-së dhe OSHEE-së u dhanë me nënhua si rezultat i ndarjes nga KESH-i. Këto hua kanë maturitete dhe normë mesatare nominale interesi që përcaktohen bazuar në marrëveshjet me huadhënësit fillestarë (Shënim 12); dhe
- Elektroprivreda Crne Gore AD Nikšić ("EPCG") në shumën 72,790 mijë Lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: 76,770 mijë Lekë), nën kushtet e projektit "Linja e transmetimit Tiranë-Podgoricë". Huaja mbart interes me një normë interesi 0.75% në vit për Pjesën I, EURIBOR+ 0.65% në vit për Pjesën II dhe një normë interesi fikse që të barazojë totalin e kostove efektive të financimit të KfW-së në tregun kapital të Euro-s për maturitetet plus shtesën prej 0.65% në vit. Pas disbursimit total të Pjesës II, KESH-i ka mundësi të kërkojë për periudhën e mbetur një ndryshim nga norma e interesit të ndryshueshëm në një normë fikse interesi.
- Për sa u përket detyrimeve për t'u paguar nga KESH-i, në zbatim të vendimeve të ERE Nr.190, datë 22.12.2016 dhe Nr. 52, datë 06.04.2017, OSHEE-ja nuk ka bërë asnjë pagesë të detyrimeve të prapambetura për qëllime të pagesave të huasë, dhe për këtë qëllim KESH-i nuk ka mundësi pagese për Ministrinë.

8. INVENTARËT

	2020	2019
Lëndë të para dhe materiale të tjera	1,513,958	1,473,307
Provizjon për inventar jashtë përdorimi	(303,334)	(303,334)
Rezerva të djegshme në TEC Vlorë	1,105,973	1,106,866
Zhvlerësim i lëndëve djegëse të TEC Vlorë	(857,143)	(722,537)
Rezerva të djegshme për KESH-in	8,779	6,019
Totali, neto	1,468,233	1,560,321

Grupi ka performuar një analizë vjetërsie të inventarit të tij për të identifikuar inventarin me ritme të ngadalta lëvizjeje dhe për të provigjonuar inventarin jashtë përdorimi. Lëvizja e provigjonit për inventarin jashtë përdorimi prezantohet si më poshtë.

Zhvlerësim i inventarit të nxjerre jashtë përdorimi

	2020	2019
Gjendja hapëse më 1 janar	303,334	303,334
Provizjon zhvlerësimi	-	-
Gjendja mbyllëse më 31 dhjetor	303,334	303,334

Zhvlerësim i lëndëve djegëse të TEC Vlorë

	2020	2019
Gjendja hapëse më 1 janar	722,537	253,770
Provizjon zhvlerësimi	134,606	468,767
Gjendja mbyllëse më 31 dhjetor	857,143	722,537

8. INVENTARËT (VAZHDIM)

Në dhjetor 2020, Grupi bëri një vlerësim në lidhje me sasinë dhe cilësinë e inventarit të naftës së mbajtur në TEC Vlorë. Në vijim të vlerësimit, në mënyrë që të përcaktonin çmimin e tregut, Drejtuesit nisën një procedure tenderimi duke ftuar shtatë pjesëmarrës të tregut për të bërë një ofertë për çmimin e inventarit të naftës së mbajtur në TEC Vlorë. Duke marrë në konsideratë mesataren e çmimeve të ofruara, çmimi i tregut për inventarin e naftës së mbajtur në TEC Vlorë rezultoi 82 Lek/litër (2019: 102 Lek/litër) me TVSH.

9. TË ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	2020	2019
Të arkëtueshmet tregtare	103,023,182	98,467,275
Të arkëtueshme të tjera	3,601,004	5,646,019
	106,624,186	104,113,294
Provizionim për zhvlerësim	(43,526,340)	(41,988,053)
	63,097,846	62,125,241

Informacioni në lidhje me ekspozimin e Grupit ndaj riskut të tregut dhe kredisë, dhe humbjeve të zhvlerësimit për të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera është përfshirë në Shënimin 5.2.1.

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2020, Grupi nuk ka njohur humbje shtesë nga zhvlerësimi (2019: 0 mijë Lekë) në lidhje me shumat e paarkëtueshme të balancave të llogarive të të arkëtueshmeve tregtare (Shënimi 5.2.1). Të gjitha të arkëtueshmet e Grupit janë vendosur si kolateral për huatë e marra nga bankat tregtare vendore. Të arkëtueshmet tregtare janë të detajuara si në vijim:

	2020	2019
<i>Të arkëtueshmet tregtare</i>		
Familje	40,627,892	40,603,223
OSHEE	56,992,414	53,382,518
FSHU	645,803	-
OST	4,644,490	4,296,376
Klientë të tjerë	112,583	185,158
Të arkëtueshme tregtare në total, bruto	103,023,182	98,467,275
Provizionim për zhvlerësim	(40,829,244)	(40,842,596)
Të arkëtueshme tregtare në total, neto	62,193,938	57,624,679

Të arkëtueshmet e OSHEE-së janë të detajuara si në vijim:

	2020	2019
Të arkëtueshme nga marrëveshja për shlyerjen e pagesave të prapambetura në vitin 2018	48,628,509	51,205,174
Të arkëtueshme nga shitja e energjisë elektrike	1,033,871	16,914
Penalitetet për shumat e papaguara për periudhën 2011-2015	2,143,030	2,143,030
Penalitetet për shumat e papaguara për periudhën 2016-2020	5,169,604	-
Të arkëtueshme për transferimin e aktiveve në vitin 2014	17,400	17,400
Gjithsej	56,992,414	53,382,518

Më 10 prill 2018, KESH-i dhe OSHEE-ja nënshkruan një marrëveshje për njohjen e shumave të pashlyera nga OSHEE-ja dhe pagesën e tyre në vitin pasardhës nëpërmjet kësteve vjetore për një periudhë prej 28 vitesh.

Duke qenë se të dyja subjektet janë në pronësi shtetërore, dhe se rikuperimi i balancave në fjalë ka qenë subjekt i një mosmarrëveshje të gjatë të iniciuar nga OSHEE-ja, e cila daton që nga privatizimi i saj në vitin 2009. Kjo marrëveshje përbën një tregues të rëndësishëm se këto të arkëtueshme do të rikuperohen nga OSHEE-ja në përputhje me afatin e përcaktuar në marrëveshje.

Gjatë viteve 2020 dhe 2019, KESH-i dhe OSHEE-ja kanë rënë dakord për penalitetet e pagesave të prapambetura të llogaritura për të arkëtueshmet tregtare të papaguara për shitjen e energjisë për periudhën 2016-2020 në shumën 5,169 milionë Lekë dhe për periudhën 2011-2015 në shumën 2,143 milionë Lekë. Palët kishin një mosmarrëveshje të gjatë për zbatueshmërinë dhe llogaritjen e penaliteteve.

9. TË ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA (VAZHDIM)

Më në fund u ra dakord për shumën, e cila u faturua dhe u njoh nga palët pas procese të rakordimit ndërmjet KESH-OSHEE, për llogaritjen e penaliteteve. Penalitetet për shumën e pashlyera janë llogaritur të të ardhurat e tjera operative (Shënimi 17).

Të arkëtueshmet nga shitja e energjisë elektrike përbëjnë faturimin aktual të energjisë dhe janë të ripagueshme brenda 30 ditësh.

Të arkëtueshme të tjera

	2020	2019
Të arkëtueshme nga Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike ("SHKEE")	862,121	862,121
Të arkëtueshme të lidhura me çështjen Jacobsen	168,173	168,173
Të arkëtueshmet nga punonjësit	37,974	37,974
Vlera e drejtë e rregullimit të huave (Shënimi 11.6)	-	2,969,584
